



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR
PËR REFORMËN NË SISTEMIN E DREJTËSISË

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E

PLATFORMËS

MBI REFORMËN NË DREJTËSI

**E EKSPERTËVE TË PROPOZUAR NGA OPOZITA
PARLAMENTARE**

(Versioni i shkurtuar)

Shtator, 2015

HYRJE

Synimi i kësaj Platforme nuk është të gjejë defekte apo të kritikojë dokumentet e prezantuar nga mazhoranca parlamentare, por synon të pasqyrojë disa sugjerime me natyrë plotësuese apo korrektuese, duke siguruar objektivitetin e pasqyrimit të të dhënave. Rezulton se Strategjia nuk është konsultuar ende me asnjë grup interesi apo aktor të drejtësisë, dhe se Komisioni i Posacem Parlamentar, ka miratuar në mënyrë të njenshme vetëm në parim draftin e paraqitur prej tyre në komision.

*Platforma jonë synon të integrohet në një Strategji të përbashkët reformuese, e cila të ofrojë zgjidhje afatgjata dhe që shkojnë përtej një mandati qeverisës. Për këtë arsye, ky opinion **synon** që saktësisht nisur prej premisave të mësipërme, të bëjë të qartë pikërisht: masën kritike të arsyeve, nevojave, objektivave dhe qëllimeve të ndryshmeve Kushtetuese/ligjore/institucionale eventuale; risqet që mund të rezultojnë; dhe po me kaq skrupolozitet edhe nevojën, mjetet konkrete dhe garancitë që duhet të vijë për të përgatitë këtë proces reformues.*

Kjo Platformë përmban jo vetëm kritikën apo opionencën ndaj masave të propozuara, por edhe mbështetjen për zgjidhjet pozitive, disavantazhet e zgjidhjeve të papërshtatshme, dhe alternativën tonë konkrete për reformimin e sistemit të drejtësisë, duke synuar në mënyrë të njëkohshme, garantimin e pavarësisë dhe forcimin e përgjegjshmërisë dhe luftën kundër korrupsionit. Për këtë arsye, mendojmë që masat e propozuara në këtë Platformë, duhet të analizohen me kujdes nga ekspertët ndërkombëtar, për të përzgjedhur zgjidhjet më të mira dhe oportune për Shqipërinë, në funksion të arritjes së objektivit për garantimin e njëkohshëm të pavarësisë së sistemit dhe luftën ndaj korrupsionit.

*Bazë e dokumentit tonë të prezantuar në këtë Platformë janë Rekomandimet e Bashkimit Europian, GRECO, Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Europian (CCJE) apo Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Europian (CCPE), Rrjetit të Këshillave Gjyqësor Europian, Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Komisionit të Venecias, dhe modelet më të mira europiane. Në këtë pikëpamje, pavarësisht kritikave të shpeshta për huazimin e pjesëve të ndryshme nga përvoja të ndryshme evropiane, pa imituar saktësisht një model të gatshëm evropian, kjo platformë pranon se **Shqipëria duhet të krijojë modelin e saj të pushtetit gjyqësor dhe të sistemit të drejtësisë, i cili pa asnjë dyshim duhet të përqafojë standardet minimale dhe praktikën më të mira evropiane dhe ndërkombëtare.** Vetëm një qasje e tillë i përshkruan dhe adreson nevojat konkrete të shoqërisë shqiptare, në kontekstin e saj historik të zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, si dhe e përgatit Shqipërinë për të përballur siç duhet proceset integruuese euro-atlantike.*

Hartimi i Platformës tonë ndjek, për aq sa është e mundur, strukturën e emërtimeve të përcaktuara në Analizën e Sistemit të Drejtësisë apo Strategjisë për të evituar konfuzionin e dokumenteve. Ne jemi të bindur se vlerësimi me kujdes i kësaj Platforme do të ndihmonte realisht në pasqyrimin me objektivitet të problematikave të sistemit dhe gjetjen e zgjidhjeve më të mira të mundshme. Cdo përpjekje për të injoruar opinionet ndryshe apo për të këmbëngulur në zgjidhje të paracaktuara, jo vetëm nuk do t'i jap zgjidhje problemeve që ka sot sistemi i drejtësisë, por do të shtojë edhe problematika të tjera, që do të rrezikonin të ardhmen evropiane të vendit.

KREU I - KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

I. Mbi procesin e Reformës në Drejtësi

Komisioni i Posacëm Parlamentar për realizimin e Reformës në Drejtësi ka miratuar në parim Dokumentin Analitik “Analizë e sistemit të drejtësi në Shqipëri” dhe Strategjinë e Planin e Veprimit për realizimin e Reformës në Drejtësi. Duke pasur si pikënisje rezultatet e sistemit të drejtësisë në këta 16 vjet që nga hyrja në fuqi e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, *Dokumenti Analitik* synon të evidentojë problematikën që prek sistemin tonë të drejtësisë në të gjitha aspektet e organizimit, funksionimit dhe administrimit të tij.

Përpjekja për të skanuar problematikën e sistemit të drejtësisë që nga momenti i hyrjes në fuqi të Kushtetutës (1998) e deri më sot, është një proces i mirëpritur, por vetëm nëse është i plotë, objektiv, gjithëpërfshirës dhe i paanshëm. Për këtë qëllim, ky proces jo vetëm duhet të realizohet me kujdes dhe pa nxitim, por mbi të gjitha duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe transparent. Konsultimi i tij duhet të jetë jo vetëm një proces formal, por mbi të gjitha një proces që ka impakt mbi përmbajtjen e këtyre dokumenteve. Edhe pse janë realizuar disa tryeza dhe takime publike konsultative, nuk rezulton që ato të kenë arritur të kenë ndikim mbi përmbajtjen e Dokumentit Analitik. Për më tepër, vetë Strategjia dhe Plani i saj i Veprimit nuk rezulton që t’i jenë nënshtruar ndonjë procesi të posacëm konsultimi me grupet e interesit. Pretendimi se ato janë konsultuar gjatë fazës së konsultimit të Dokumentit Analitik (*dmth përpara se të hartoheshin nga vetë Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë!!!*), është jo i besueshëm dhe aspak serioz.

ENCJ, lidhur me procesin e një Reforme në Gjyqësor jep këto rekomandime:

- 1) Është thelbësore që gjyqësori, këshillat gjyqësorë dhe në veçanti gjyqtarët dhe prokurorët të përfshihen në çdo fazë të zhvillimit dhe të zbatimit të planeve të reformës. Kjo siguron pavarësinë e gjyqësorit dhe që reformat janë efektive dhe besimplotë;
- 2) Gjyqësori, nën drejtimin e Këshillave Gjyqësore, aty ku ata ekzistojnë, duhet të zhvillojnë propozime të arsyeshme për reforma efektive. Qëllimi i reformës duhet të jetë përmirësimi i vlerave të përgjithshme të drejtësisë. Administrimi më efektiv rezulton në përmirësime të kohëzgjatjes dhe të cilësisë;
- 3) Këto propozime për reforma duhet të marrin informacion nga drejtimet e përgjithshme të skicuara në këtë raport. Në veçanti, kombinimi i thjeshtimit të procedurave, menaxhimit më strikt të çështjeve dhe dixhitalizimi ofrojnë një perspektivë për vlera gjyqësore.

Duke i konfrontuar këto standarde dhe rekomandime me Dokumentin Analitik dhe draft-Strategjinë, konstatohet se në këto 2 dokumente nuk është trajtuar aspak rëndësia e procesit të Reformës dhe procedura që do të ndiqet për realizimin e saj. Kjo çështje mesa duket i është lënë në dorë nivelit politik (Komisionit Parlamentar të Reformës), i cili me disa vendime ka elaboruar disa rregulla tepër të thjeshta, por që nuk përmbushin në nivelin e duhur standardet evropiane. Ritheksojmë se është e vërtetë që janë zhvilluar disa tryeza të rrumbullakëta diskutimi me gjyqtarë, kryetarë gjykatash, shoqata të gjyqtarëve dhe me përfaqësues të KLD-së. Sikundër është e vërtetë edhe që është krijuar një regjistër me adresat elektronike të të gjithë gjyqtarëve, me qëllim informimin e tyre dhe marrjen e mendimit prej tyre. Mirëpo, pjesëmarrja me këtë lloj procedure e gjyqësorit në Reformë

është sipërfaqësore dhe nuk siguron aktivizimin substancial të tij. Është e tepërt të shënohet se individët që paraqiten në këto forume veprojnë individualisht dhe pa qenë të organizuar. Për më tepër kjo bëhet e ndjeshme për shkak të mentalitetit normal të një gjyqtari, i cili ka në edukatën e punës së tij punën individuale dhe jo në grup. Kjo është arsyeja që standardi evropian kërkon përfshirjen e gjyqësorit nën drejtimin e Këshillit Gjyqësor, me qëllim organizimin real të tyre, mbledhjen e problematikave, përpunimin shkencor të tyre dhe paraqitjen e sugjerimeve serioze.

Gjithashtu, është thelbësore që hartuesit e dokumentit duhet të jenë të balancuar politikisht (të paanshëm dhe të pavarur si rregull), me qëllim që pasqyrimi të jetë objektiv dhe jo partiak apo i njëanshëm. Prezenca e ekspertëve ndërkombëtar është një garanci për të siguruar objektivitetin e procesit, por pjesëmarrja e tyre nuk eliminon tërësisht mungesën e besimit në njëanshmërinë e një numri të lartë të ekspertëve vendas, roli i të cilëve duket të ketë qenë vendimtar për përmbajtjen e vetë dokumenteve. Edhe pse Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë prezantohet si një grup ekspertësh “të pavarur”, pjesëmarrja në shumicë në të i ish-Ministrave, ish-zëvendësministrave, ish-funksionarëve të tjerë të lartë gjatë qeverisjes së Partisë Socialiste, familjarëve të deputetëve e ministrave të Partisë Socialiste, apo eksponentëve të lartë të sistemit gjatë regjimit komunist, dëmton besueshmërinë e tyre si ekspertë të pavarur dhe jo partiak, duke cenuar kështu objektivitetin e realizimit të procesit të analizimit të problematikave të sistemit dhe ofrimit të zgjidhjeve të mundshme jopartiake.

Në këto kushte, vlerësojmë se është thelbësore që grupi i ekspertëve të jetë i balancuar dhe të pasqyrojë për aq sa është e mundur përbërjen e vetë Komisionit të Posacëm Parlamentar. Nga ana tjetër, duhet që realisht ekspertët të zhvishen nga konflikti i interesit dhe të mos kenë kompleksin për të pranuar se gjatë kohës kur kanë patur funksione drejtuese në sistemin e drejtësisë kanë dështuar të rrisin besueshmërinë e publikut tek sistemi apo ta mbajnë sistemin larg akteve korruptive!

Është gjithashtu thelbësore që analiza e sistemit të drejtësisë të mos bazohet në të dhëna subjektive dhe opinione personale të pabazuara, por duhet të realizohet sipas një procesi karahasimor midis realitetit të brendshëm dhe standardeve ndërkombëtare në këtë fushë. Në Dokument rezulton se mungojnë referimet në aktet ndërkombëtare që përcaktojnë standardet e organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë. Për ilustrim, mjafton të përmendim faktin se Dokumenti nuk referon në aktet e miratuara nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Europian (CCJE) apo Këshillit Konsultativ i Prokurorëve Europian (CCPE), aktet e të cilave përbëjnë frymëzim për realizimin e reformave në të gjitha vendet e Bashkimit Europian apo vendeve që aspirojnë t'i bashkohen familjes europiane. Në këtë pikë, rezulton se Dokumenti “Analizë e sistemit të drejtësisë” ka dështuar të ofrojë një analizë të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare.

Qëllimet e reformës në gjyqësor duhet të bazohen në parime të shëndosha që përmirësojnë cilësinë e drejtësisë për qytetarët dhe që duhet të përfshijnë këto aspekte:

- Përmirësimin e cilësisë së aksesit në drejtësi;
- Rritjen e besimit publik në sistemin gjyqësor;
- Përmirësimin e imazhit të gjyqësorit;
- Garantimin e një sistemi eficient që nuk kompromenton cilësinë e drejtësisë dhe aksesin në drejtësi.

Duke u bazuar në këto qëllime, vizioni që përshkon këtë pjesë të platformës tonë është **reformimi i sistemit gjyqësor shqiptar, përmes forcimit të njëkohshëm të pavarësisë dhe të përgjegjshmërisë së tij, për ta bërë atë lehtësisht të aksesueshëm, të besueshëm nga publiku, me integritet të lartë dhe eficient në dhënien e një drejtësie me cilësi të lartë.** Artikulimi i këtij vizioni bazohet në bindjen se reforma e sistemit gjyqësor duhet të konceptohet si përpjekje për të përmirësuar funksionimin e gjyqësorit, duke mbajtur në konsideratë edhe impaktin domethënës të krizës ekonomike (numri i çështjeve rritet në gjykata, ndërsa buxheti shtetëror ulet), si dhe faktin që performanca e dobët e gjyqësorit është një faktor që pengon zhvillimin ekonomik të vendit.

Shpallja e këtij vizioni nuk ka kundërthënë me synimin e përgjithshëm të deklaruar në draft-Strategji, por në ndryshim të këtij synimi, vlerësohet se **duhet me forcë të deklarohet forcimi i njëkohshëm dhe i balancuar i pavarësisë dhe i përgjegjshmërisë së gjyqësorit.** Theksimi i kujdesit për të dyja parimet lidhet me historinë institucionale dhe gjendjen aktuale të gjyqësorit në Shqipëri, që ka treguar se injorimi i njërit parim ka ndikuar ndjeshëm në cenimin e parimit tjetër. Sot, ka një shqetësim mbarëshoqëror për rritjen e përgjegjshmërisë së gjyqësorit në Shqipëri, por një Reformë e kujdesshme afatgjatë duhet të konsiderojë që masat për rritjen e përgjegjshmërisë duhet pa asnjë dyshim të ndërmerren duke respektuar nevojën e padiskutueshme për ruajtjen e pavarësisë së gjyqësorit. Theksimi i kujdesit për të dyja parimet nxitet edhe nga përmbajtja e Dokumentit Analitik dhe i disa pjesëve të draft-Strategjisë, të cilat i kushtojnë vëmendje rritjes së përgjegjshmërisë së gjyqësorit në Shqipëri, duke mos prezantuar masa apo mekanizma balancues për ruajtjen e njëkohshme të pavarësisë së tij.

Në Raportet e tij për Reformën në Gjyqësor, ENCJ rekomandon se objektivat e Reformës duhet të jenë SMART (specifike, të matshme, të arritshme, realiste dhe me afate të mirë-përcaktuara). Nga pikëpamja e procesit të Reformës, ajo duhet të përbëhet nga një set hapash proceduralë, si:

- (i) Plani i Veprimit;
- (ii) Procedurat për angazhimin dhe përfshirjen e Gjyqësorit në të gjitha fazat;
- (iii) Projektet pilot;
- (iv) Afatet kohore të përshkallëzuara;
- (v) Rishikimi i afateve;
- (vi) Kriteret e rishikimit;
- (vii) Datat dhe procedurat e zbatimit;
- (viii) Kërkesa që propozimi bazohet në të dhëna aktuale dhe relevante;
- (ix) Vlerësimet e impaktit – cilësia dhe sasia;
- (x) Kontrolli i Cilësisë në çdo fazë.

Çështja e fundit, që lidhet me procesin e Reformës, është ajo e **strukturimit formal të çështjeve substanciale të saj.** Në Raportin Reforma Gjyqësore në Evropë 2011-2012 të Rrjetit Evropian të Këshillave Gjyqësorë (ENCJ), janë analizuar 5 fusha të Reformës së Gjyqësorit:

1. Racionalizimi dhe (ri)organizimi i gjykatave dhe i zyrave të prokurorisë;
2. Ulja e volumit të çështjeve në gjykata;
3. Thjeshtimi i procedurave gjyqësore, përmirësimi në menaxhimin e çështjeve dhe prezantimi i teknologjive të reja;
4. Financimi i sistemit gjyqësor (gjykatat dhe zyrat e prokurorisë);
5. Menaxhimi i gjykatave dhe ndarja e çështjeve brenda dhe midis gjykatave, si dhe brenda dhe midis zyrave të prokurorisë.

II. Mbi Dokumentin Analitik

1- Dokumenti Analitik përpiqet të bëjë një skanim të gjendjes aktuale të sistemit të drejtësisë në vend, por problematikat e evidentuara nuk pasqyrojnë gjithmonë realitetin apo nuk janë në cdo rast të provuara apo vërtetuara nga burime informacioni të sakta apo statistikore.

2- Edhe pse dokumenti është voluminoz dhe citon Dokumente të ndryshme vendase apo ndërkombëtare, rezulton se ai nuk ka arritur të bëjë një skanim të plotë të gjendjes aktuale në sistemin e drejtësisë. Në këtë këndvështrim do të ishte e përshtatshme që të bëhej një ballafaqim i përputhshmërisë së situatës ligjore dhe institucionale në vend me standardet ndërkombëtare në këtë fushë. Nga ana tjetër, është e nevojshme që të saktësohen në cdo rast shkaqet që kanë sjellë këtë situatë. Nëse nuk evidentohen shkaqet atëherë jemi të destinuar për të dështuar që të gjejmë edhe zgjidhjet më të vlefshme dhe për të garantuar që të njëjtat problematika nuk do të shfaqen përsëri në të ardhmen.

3- Në Dokument shpesh vihet re një mungesë e theksuar e përputhshmërisë midis analizës, gjetjes dhe përfundimeve. Jo të gjitha problematikat e evidentuara prezantohen edhe në përfundime. Madje edhe citimi i Dokumenteve ndërkombëtare bëhet në mënyrë të fragmentarizuar, pa arritur të pasqyrojë plotësisht mospërputhjen e evindentuar.

4- Në Dokument vihet re një subjektivizëm i theksuar në trajtimin e problemeve. Shpesh problem thuhet se është evidentuar nga publiku apo nga ndjekës të afërt të sistemit, por pa treguar burimin. Gjithashtu, dokumenti në disa pjesë të tij përmban edhe konsiderata politike, të cilat vlerësojmë se janë të dëmshme dhe nuk e ndihmojmë procesin. Në funksion të rritjes së besimit mbi analizën është e nevojshme që të citohet saktësisht burimi i informacionit dhe të shmanget vlerësimi subjektiv apo përpjekjet për të vlerësuar punën e institucioneve të drejtuara nga ndonjë ekspert, apo për të kritikuar pa fakte punën e institucioneve të papërfshira në Grupin e Ekspertëve.

5- Dokumenti të krijon perceptimin se të gjitha përmirësimet sistemit janë bërë përpara 2005 (ku cuditërisht nuk ka patur probleme), ndërkohë që të gjitha problemet janë konstatuar pas këtij viti. E vërteta është krejt ndryshe. Para vitit 2005 sistemi i drejtësisë ka vuajtur kapjen më të paimagjinueshme të tij nga Partia Socialiste. Për pasojë, standardi i objektivitetit kërkon që pasqyrimi të jetë i saktë dhe të përfshijë problematikat e sistemit nga periudha pas miratimit të Kushtetutës dhe deri më sot, sikundër duhet të evidentohen arritjet që ka patur sistemi gjatë gjithë kësaj periudhe.

6- Dokumenti përmban informacione të panevojshme që jo vetëm rëndojnë pa arsye përmbajtjen e tij, por mbi të gjitha krijojnë konfuzion tek lexuesi. Për ilustrim, edhe pse Dokumenti Analitik përmban më shumë se 50 faqe me statistika, në asnjë moment nuk i merr në analizë ato dhe nuk evidenton problematikat që dalin nga përpunimi i tyre.

7- Struktura e Dokumentit Analitik është krejtësisht e papërshtatshme. Cështje të njëjta apo institucione të njëjta trajtohen në Kapituj të ndryshëm, duke sjell jo vetëm ripërsëritje të informacioneve, por shpesh edhe mospërputhje midis tyre. Në këtë drejtim, Dokumentit i mungon një mekanizëm i përshtatshëm referimi, i cili do të

lehtësonte lexuesit e tij për të patur informacionin e plotë për një problem apo institucion. Për ilustrim, nëse një lexues dëshiron të njihet me analizën për KLD-në, duhet ta gjej atë të shpërndarë në të paktën 3 kapituj brenda dokumentit (ndryshimet kushtetuese, gjyqësori, antikorrupsioni).

8- Analiza e bërë nga Dokumenti të krijon perceptimin se problem madhor për sistemin e drejtësisë është organizimi i tij dhe jo mënyra e funksionimit. Në tërësinë e tij i gjithë dokumenti nuk analizon problematikën nga këndvështrimi i ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve, por nga mënyra sesi zgjidhen apo emërohen funksionarët publik. Në vlerësimin tonë, problematikat duhet të analizohen nga mënyra sesi funksionon sistema dhe sesa eficient është ai në përmbushjen e misionit të vet.

III. Mbi Strategjinë dhe Planin e Veprimit

1- Dokumenti Strategjik më tepër se një Strategji për Reformën në Drejtësi është një përmbledhje me masat e përgjithshme që do të ndërmarrë Komisioni i Posaçëm Parlamentar, brenda afatit të tij. Kjo i jep dokumentit tiparet e një Dokumenti Emergjence, me tepër se një Dokumenti Strategjik. Në vlerësimin tonë, Reforma në Drejtësi nuk do mund të jetë e plotë dhe tërësore, nëse masat e përfshira në Dokumentin Strategjik nuk parashikojnë jo vetëm ndërhyrjet afatshkurtra në legjislacion, por edhe ndërhyrje afatgjata të shtrira në të paktën 5 vitet e ardhshme.

2- Masat e parashikuara në Dokumentin Strategjik janë me natyrë të përgjithshme, shpesh të paqarta dhe të pamundura për t'u matur. Në asnjë moment Dokumenti Strategjik nuk analizon avantazhet dhe disavantazhet e zgjidhjeve që ofron, përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare në këtë fushë, apo detajet sesi do të vihen në zbatim këto masa dhe në çmënyrë do të eliminojnë problematikat e evidentuara deri më tani.

3- Konstatohet lehtësisht mospërputhje midis problematikave të evidentuara në Dokumentin Analitik dhe masave të propozuara në Dokumentin Strategjik. Konkretisht, Dokumenti Strategjik ofron zgjidhje për problem të patrajtuara nga Dokumenti Analitik, ose lë pa zgjidhje disa problematika të evidentuara nga ky i fundit.

4- Për ne përbën shqetësim madhor fakti i afateve të Strategjisë së Reformës në Drejtësi, ku në Planin e Veprimit, masat e parashikuara rëndom përcaktojnë si afat periudhën 'shtator-dhjetor 2015'. Ky afat nuk është serioz dhe aspak realist. Qëndrimi ynë mbi këtë çështje është që Strategjia të ketë formatin dhe afatet e veprimit të kërkuara nga Bashkimi Europian. Strategjia duhet të parashikojë masa për periudhën 2015-2020, duke u shoqëruar me një Plan të saktë dhe të plotë Veprimi, ku parashikohen edhe mekanizmat e monitorimit apo komponentët financiar. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet edhe mbështetje financiare nga Bashkimi Europian, për realizimin e masave me natyrë reformuese të sistemit të drejtësisë.

5- Nga ana tjetër, në Strategji nuk flitet fare për pilotim të disa masave që prezantohen për herë të parë; për rishikim të masave të planifikuara; për kontroll impakti dhe cilësie, apo për kostim financiar të masave të propozuara. Për pasojë, sugjerohet që të kërkohet krijimi i një procedure rigoroze të paracaktuar për të patur

garancinë e nevojshme për drejtësinë e rezultateve të Reformës. Kjo procedurë, duhet të bazohet në rekomandimet e ENCJ.

6- Janë me dhjetra rekomandime, të deklaruara në draft-Strategji, të cilat “kanë mbirë” në këtë dokument nga “asgjëja”. Për to nuk është konsumuar asnjë rresht i vetëm në Dokumentin Analitik, për trajtimin e tyre, për nevojën e parashikimit të tyre, për problematikën që eventualisht paraqet gjendja aktuale apo për modelin apo standadin ndërkombëtar të ndjekur teksa janë përzgjedhur si zgjidhje, për t’u ndjekur përgjatë procesit të draftimit të ndryshimeve ligjore. Kjo mangësi flagrante vendos në krizë jo vetëm seriozitetin e gjithë dokumentit, por edhe dobishmërinë praktike të trajtimit të këtyre zgjidhjeve. Në këtë situatë ka dyshime të forta se mbi ç’bazë është identifikuar si zgjidhje secila prej këtyre rekomandimeve. **Një gjë është e sigurt: zgjidhje apo rekomandime të tilla nuk janë produkt logjik i veprimtarisë studimore të kryer nga ekspertiza, e përmbajtur në Dokumentin Analitik.**

KREU II – KOMENTE DHE PLOTËSIME MBI DOKUMENTIN ANALITIK

I. ANALIZA KUSHTETUESE MBI REFORMËN NË DREJTËSI DHE ANALIZA LIGJORE MBI REFORMËN NË GJYKATËN KUSHTETUESE

1) Në Dokumentin Analitik, Ndryshimeve Kushtetuese i është kushtuar Kreu IV, i përbërë nga 30 faqe, i strukturuar në 5 pjesë: (I) Hyrja; (II) Analiza Kushtetuese mbi Reformën në Drejtësi; (III) Përmbledhje e Gjetjeve; (IV) Analiza Ligjore mbi Reformën e Gjykatës Kushtetuese; (V) Përmbledhje e Gjetjeve; dhe (VI) Përfundime. Materiali në këtë pjesë ka probleme strukturore, pasi kalohet disa herë në tautologji zinxhir, të tipit “fakte – përmbledhje e fakteve-përfundime të fakteve”. Këto probleme strukturore e bëjnë tekstin e vështirë, të paqartë, me mbivendosje të papërshtatshme dhe shpesh edhe me inkoherenca substanciale. Nga ana tjetër, struktura nuk është shteruese për ndryshimet kushtetuese sepse shumë çështje të këtij niveli janë prezantuar në kapitujt e tjerë (psh analiza e prokurorisë ndodhet në kapitullin “drejtësia penale”, apo çështja e një pjese të statusit kushtetues të gjyqtarëve ndodhet në kapitullin “Antikorupsioni”). Gjithashtu, edhe pse shqetësimi kryesor i qytetarëve dhe partnerëve ndërkombëtar është lufta ndaj korrupsionit, në asnjë rresht të analizës nuk përmendet raporti i GREECO-s, i cili është shumë i rëndësishëm edhe për reformën në nivel kushtetues.

2) Përgjatë gjithë tekstit të Kapitullit, vihet theksi tek emërimet dhe shkarkimet. Për ilustrim, fjala “shkarkim” është përdorur 34 herë, ndërsa “emërim” është përdorur 57 herë në këtë Kapitull, që përbëhet nga 30 faqe. Në fakt, shqetësimi kryesor duhet të ishte efënca e sistemit. I gjithë teksti paraqet si shqetësim miratimin e disa figurave kyçe me shumicë të thjeshtë në Kuvend sepse duket që duhet t’i hapet rrugë miratimit me shumicë të cilësuar. Kjo është problematike sepse në Shqipëri çështja nuk qëndron tek numrat, por tek mungesa e dialogut dhe besimit të ndërsjellë politik, që mund të zgjidhet vetëm me procedura për kompetenca të qarta dhe pa mbivendosje midis organeve shtetërore. Jo vetëm kaq, por është shpikur një koncept i ri. Në tekst nuk përdoret koncepti “shumicë e thjeshtë” por “shumicë minimale (36 vota) dhe përdoret disa herë. Nuk ka ndodhur asnjëherë në Shqipëri që një zyrtar të jetë zgjedhur me 36 vota. Duket që ky argument është përdorur për të sugjestionuar leximin jo të thelluar të materialit në pikëpamje imazhi, sepse profesionistët e konstatojnë lehtësisht pasaktësinë dhe tendencën e tij.

3) Në **pjesën I, të emërtuar “Hyrja”** jepen konkluzione për reformimin kushtetues të sistemit të drejtësisë, si dhe për reformimin e Gjykatës Kushtetuese. Konkluzionet janë të përcipta dhe nuk mbështeten nga argumente mbi difektet e tekstit kushtetues apo mbi keqzbatimin në praktikë të tekstit kushtetues.

4) Në **pjesën II, të emërtuar “Analiza Kushtetuese mbi Reformën në Drejtësi”** përshkruhet kuadri kushtetues dhe ligjor, si dhe institucionet kushtetuese që lidhen me drejtësinë (Presidenti, Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, KLD, Konferenca Gjyqësore Kombëtare dhe Prokurororia). Në këtë pjesë konstatohen probleme të tilla si:

- Mungesa e kuadrit të plotë kushtetues apo ligjor sepse mungojnë normat kushtetuese mbi statusin e gjyqtarit apo mungon ligji organik për gjyqësorin;
- Për rolin e Presidentit të Republikës ka një trajtim aspak profesional, madje me doza njëanshmërie. Mungon trajtimi historik i këtij institucioni, mungojnë të dhënat konkrete dhe përshtypjet janë të fokusuar tek Presidenti aktual. E gjithë analiza është orientuar vetëm tek numri i votave për zgjedhjen e Presidentit.

- Tek Efienca dhe Efektiviteti i Gj.Kushtetuese, ka inkoherencë logjike shkak-pasojë, midis shpalosjes së problematikave dhe identifikimit të shkaqeve.
- Tek Përbërja e KLD-së, ka trajtim haptazi të njëanshëm dhe standard i dyfishtë për analizën mbi anëtarët e zgjedhur nga gjyqësori në raport me Ministrin e Drejtësisë dhe anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi. Ka deformim të konceptit të konfliktit të interesit për anëtarët e KLD, të zgjedhur nga gjyqësori. Ka identifikim të përciptë të problemit, kur thuhet se anëtarët zgjidhen nga Kuvendi me shumicë minimale (madje shpiket ky si koncept, sepse Kushtetuta i referohet me shumicë të thjeshtë). Nuk është analizuar lloji i mandatit, që duhet të kenë anëtarët e zgjedhur në KLD, mandat detyrues, mandat përfaqësues apo mandat të pavarur. Nuk ka asnjë shpjegim për konceptin “rol tepër aktivist i Presidentit në KLD”;
- Tek Pozita e Ministrit të Drejtësisë, ka një standard të ndryshëm nga trajtimi i anëtarëve të KLD. Ka mangësi sepse identifikohet si problem vetëm kompetenca ekskluzive për procedimin disiplinor dhe nuk janë trajtuar kompetencat e tjera të tij për sistemin e drejtësisë, që nuk kanë një bazë të shëndoshë kushtetuese. Është vendosur një fjali pa vend për Presidentin, ku thuhet se ai i emëron gjyqtarët për shkakun se është kryetar i KLD. Gjithashtu, ka inkoherencë me pjesët “Përmbledhja e Gjetjeve” dhe “Përfundime”;
- Për KGjK nuk ka inkoherencë me pjesën “Përmbledhje e Gjetjeve” dhe me pjesën “Përfundime”. Analiza e këtij institucioni është e përciptë dhe e munguar;
- Për Prokurorinë, ka inkoherencë me pjesët “Përmbledhja e Gjetjeve” dhe “Përfundime”, pasi këtu lista e problemeve është më e gjatë. Nuk justifikohet konkluzioni që afati 5 vjeçar i Prokurorit të Përgjithshëm është i pasuksesshëm. Nuk merr kuptim pse komisionet hetimore paraqiten si problem i Prokurorit, ndërkohë që shpaloset si problem mungesa e llogaridhënies nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm. Mungon analiza korrekte e pozicionimit kushtetues dhe i kompetencave kushtetuese të Prokurorit të Përgjithshëm. Problematika nuk mbështetet me statistika dhe studime të mirëfillta. Mungon problemi i raportit të Prokurorit të Përgjithshëm me Ministrin e Drejtësisë dhe Këshillin e Ministrave.

5) Në pjesën III, të emërtuar “Përmbledhje e Gjetjeve” jepen përmbledhje e problematikave kushtetuese të përshkruara në pjesën II. Ka probleme inkoherence dhe njëanshmërie të përshkruara më lart.

6) Në pjesën IV, të emërtuar “Analiza Ligjore mbi Reformën e Gjykatës Kushtetuese”, përshkruhet ligji organik i GjK, duke bërë paraqitje skematike të tekstit të ligjit. Më pas vijohet me prezantimin e Gjendjes Aktuale. Në këtë pjesë, dokumenti paraqet problemet e mëposhtme:

- Tek emërimi i gjyqtarëve në GjK ka njëanshmëri në trajtimin e çështjes, prezantohen problemet në formën e opinionëve, pa statistika dhe pa studime të mirëfillta. Ka inkoherencë me pjesët “Përmbledhje e Gjetjeve” dhe “Përfundime”, madje edhe pasaktësi ligjore. Për ilustrim, tek kjo pjesë përmendet afati ligjor 1 muajor për fillimin e procedurës së zëvendësimit të gjyqtarit kushtetues që i ka mbaruar mandati, ndërsa tek dy pjesët e tjera konkludohet që ligji nuk ka afat. Komentohet sërish Presidenti me opinionin “kohët e fundit janë refuzuar në Kuvend shumë dekrete”;
- Tek Përfundimi i Mandatit të Gjyqtarit Kushtetues, ka mungesa të problemit të veprimeve që bën gjyqtari, i cili është zëvendësuar;

- Tek Procedurat e Gjykimit Kushtetues, tek Subjektet, janë trajtuar problemet pa statistika dhe pa studime të mirëfillta. Nuk ka qasje të njëjtë për të gjitha subjektet. Trajtohet si problem dhe sugjerohet të zgjerohet rrethi i subjekteve që kërkojnë papajtueshmërinë apo zgjedhshmërinë e Presidentit. Një difekt i tillë nuk evidentohet për deputetin. Ka gabime të nivelit teknik lidhur me KLSH dhe financimin e partive politike. Ka inkoherencë me pjesët “Përmbledhje e Gjetjeve” dhe “Përfundimet”. Ka pasaktësi teknike, kur lihet të nënkuptohet që Kushtetuta i jep të drejtën individit të godasë një normë ligjore. Ka mangësi për të drejtën e individit, i cili nuk i ka shterruar të gjitha mjetet juridike (rasti i zvarritjes – i hapur si praktikë së fundmi nga jurisprudenca e GjK);
- Tek Procedurat e Gjykimit Kushtetues, tek Afati i Kërkesës, ka një analizë aspak profesionale dhe diletante të afatit 3 vjeçar. Ka harresa në trajtimin e afateve sepse nuk flitet për afatet e mosmarrëveshjeve për kompetencë midis pushteteve dhe për afatet e kontrollit incidental. Sërish përmendet si problem që ka mungesë afati për të filluar procedurën e shkarkimit të Presidentit;
- Tek Procedurat e Veçanta ka një fokusim dhe analizë të pasaktë për shkarkimin e Presidentit të Republikës. Ndonëse paraqitet si problem përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve kushtetues, ky problem është zhdukur tek “Përmbledhja e Gjetjeve dhe “Përfundimet”. Ndonëse evidentohet si problem mbivendosja e kompetencës së GjK me Kolegjin Zgjedhor për verifikimin e zgjedhjes së deputetit, ky problem është zhdukur nga “Përmbledhja e Gjetjeve dhe Përfundimet”. Ka ngushtim të konceptit kushtetues të procesit të rregullt ligjor. Mungon dhe nuk është trajtuar problematika e abuzimit të kompetencës së Gjykatës Kushtetuese me kërkesat për proces të rregullt ligjor, ku shpesh marrin kompetencën e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndonëse identifikohet si problematikë procedura e kushtetutshmërisë së partive politike, është zhdukur nga “Përmbledhja e Gjetjeve dhe Përfundimet”. Ndonëse paraqitet si problematikë mungesa e kompetencës së GjK për kontrollin e marrëveshjeve ndërkombëtare që lidh KM, është zhdukur nga “Përmbledhja e Gjetjeve dhe Përfundimet”;
- Tek Shpallja dhe Zbatimi i Vendimeve të GjK, ka njëanshmëri në trajtimin e problemit. Nuk identifikohet dhe denoncohet praktika abuzive e kohëve të fundit të GjK që shpall vendime të paarsyetuara. Jepet si problematikë se organet shtetërore nuk zbatojnë vendimet e GjK dhe ilustruhet me nismat ligjvënëse të periudhës 2005-2013. Tek efektet e vendimit, merret sërish si shembull procedura e shkarkimit të Presidentit;
- Tek Pozita e këshilltarëve të gjyqtarëve ndiqet standard i ndryshëm. Mungon qasja për përgjegjësinë disiplinore dhe shkarkimin e tyre, flitet vetëm për rritje në karrierë dhe trajtim financiar të tyre;

7) Në **pjesën V, të emërtuar “Përmbledhje e Gjetjeve”** jepen përmbledhje e problematikave ligjore të përshkruara në pjesën IV. Ka probleme inkoherence dhe njëanshmërie të përshkruara më lart.

8) Në **pjesën IV, të emërtuar “Përfundime”** riprodhohen, thuajse pa ndryshime, dy pjesët “Përmbledhje e Gjetjeve”. Edhe kjo pjesë reflekton inkosistencë dhe njëanshmëri siç shpjegohet më lart.

(Për më shumë mbi këto çështje, lutemi referojuni Pjesës së Tretë, Kreu I, të Versionit të Plotë të Platformës “Mbi Reformën në Drejtësi”.)

II. ANALIZA E SISTEMIT GJYQËSOR

1) Në dokumentin analitik, Sistemit Gjyqësor i është kushtuar Kreu IV, i përbërë nga 115 faqe, i strukturuar në 5 çështje: (I) Hyrja; (II) Kuadri Kushtetues dhe Ligjor; (III) Prezantimi i Gjendjes Aktuale; (IV) Përmbledhje e Gjetjeve; dhe (V) Përfundime.

2) Në **pjesën I “Hyrja”** identifikohen 9 çështje, por në vijim materiali nuk është koherent sepse problematikat identifikohen ndryshe. Konkretisht ka devijim tek konceptet e pavarësisë dhe të paanshmërisë, të cilat janë konvertuar në mirëqeverisje dhe statusi i gjyqtarit. Po ashtu, administrimi nuk është çështje më vete por paraqitet si temë përmbledhëse e transparencës dhe e efijencës.

3) Në **pjesën II “Kuadri kushtetues dhe ligjor”** listohen dispozitat kushtetuese, aktet relevante ndërkombëtare dhe kuadri ligjor i brendshëm. Paraqitja është e tyre është listim skematik dhe për më tepër është i varfër, sidomos tek aktet ndërkombëtare.

4) Në **pjesën III “Prezantimi i gjendjes aktuale”** flitet për 5 çështje: (1) organizimi gjyqësor; (2) mirëqeverisja e gjyqësorit; (3) statusi i gjyqtarit; (4) administrimi i gjyqësorit, ku përfshihen transparenca dhe efijenca; dhe (5) ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Nuk trajtohen veçmas, siç përmenden në Hyrje pavarësia, paanshmëria dhe profesionalizmi. Ndërsa transparenca dhe efijenca janë bërë pjesë e administrimit të gjyqësorit. Në hartimin e kësaj pjese kemi konstatuar probleme të tilla si:

- mungesa e problematikës së organizimit gjyqësor në raport me aksesin në drejtësi të qytetarëve. Mungon përshkrimi i reformës territoriale dhe papërputhshmëria e organizimit gjyqësor me organizimin territorial;
- nxjerrje e fakteve bazuar në opinione dhe mungesë të të dhënave të sakta shkencore apo e shembujve ilustrues, që të mbështesin problematikën e identifikuar;
- mungesë të evidentimit të problemeve për institucione të caktuara, për të cilat jepet thjesht përshkrim ligjor institucional. Një rast i tillë është kryetari i Gjykatës së Lartë;
- ometim të institucioneve të caktuara, siç është rasti i ZABGj-së apo i Shkollës së Magjistraturës;
- përdorim i standardeve dyfishe për vlerësimin e performancës së institucioneve ku goditen vetëm KLD dhe Inspektorati i tij, ndërsa performanca e institucioneve të tjera konvertohet në problem ligjor;
- mungesë koherence e kësaj pjese me pjesët vijuese të Analizës, që janë përmbledhje e gjetjeve dhe e konkluzioneve. Më konkretisht, tek përmbledhja e gjetjeve dhe e konkluzioneve ka pjesë më të zgjeruara problemesh se sa tek vetë kjo pjesë që i dedikohet përshkrimit të problemeve.

5) Më në detaje, “Prezantimi i Gjendjes Aktuale”, tek nënçështja “Organizimi gjyqësor” përshkruhen:

- Gjykata e Lartë (kompetenca lëndore, organizimi dhe funksionimi, kryetari i Gjykatës së Lartë, mënyra e zgjidhjes së çështjeve, ndërveprimi me Gjykatën Kushtetuese, të dhëna statistikore). Nuk jepen problematika dhe ka inkoherencë me Pjesën e Përmbledhjes së Gjetjeve dhe me Pjesën e Përfundimeve, ku identifikohen problematika.
- Gjykatat e Apelit të juridiksionit të zakonshëm (numri shpërndarja gjeografike, kompetenca lëndore dhe tokësore dhe të dhëna statistikore). Nuk jepen

- problematika, por përdoret gjuhë për avantazhe të reformave të shtatorit 1997, që jep doza të njëanshmërisë së ekspertëve. Ka inkoherencë me Pjesën e Përmbledhjes së Gjetjeve dhe me Pjesën e Përfundimeve, ku identifikohen problematika.
- Gjykata e Apelit për Krime të Rënda (numri, shpërndarja gjeografike dhe kompetenca lëndore, si dhe të dhëna statistikore). Nuk përshkruhen problematika dhe ka inkoherencë me Pjesën e Përmbledhjes së Gjetjeve dhe me Pjesën e Përfundimeve, ku identifikohen problematika.
 - Gjykata Administrative e Apelit (numri, shpërndarja dhe kompetenca lëndore, si dhe të dhëna statistikore). Nuk përshkruhen problematika dhe ka inkoherencë me Pjesën e Përmbledhjes së Gjetjeve dhe me Pjesën e Përfundimeve, ku identifikohen problematika.
 - Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të zakonshëm (numri, shpërndarja gjeografike dhe kompetenca lëndore, si dhe të dhënat statistikore). Përshkruhet si problematikë vetëm kompetenca e kryetarit të Gjykatës për organizimin e brendshëm në gjykatë. Kjo problematikë humbet tek Përmbledhja e Gjetjeve, ku përshkruhen problematika të tjera.
 - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (të dhëna për organizimin dhe për statistikat). Jepet si problematikë vështirësia në menaxhimin e dy godinave të gjykatës me 1 kryetar dhe me 1 kancelar, që reflekton tek cilësia dhe shpejtësia e shërbimit për publikun. Kjo problematikë humbet më pas tek pjesët e tjera të dokumentit sepse nuk përmendet më tek “Përmbledhja e Gjetjeve” dhe tek “Konkluzionet”.
 - Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (numri, shpërndarja gjeografike dhe kompetenca lëndore, si dhe statistika). Nuk jepen problematika, por theksohen reformat që përjashtojnë periudhën 2005-2013. Nuk përshkruhen problematika dhe ka inkoherencë me Pjesën e Përmbledhjes së Gjetjeve dhe me Pjesën e Përfundimeve, ku identifikohen problematika.
 - Gjykatat administrative të shkallës së parë (numri, shpërndarja gjeografike dhe kompetenca lëndore, si dhe statistika). Tek të dhënat statistikore, është përdorur standard tjetër, jepet si problematikë volumi shumë i lartë i çështjeve. Një problematikë e tillë nuk është dhënë tek Gjykata e Apelit Administrativ. Ka inkoherencë me Pjesën e Përmbledhjes së Gjetjeve dhe me Pjesën e Përfundimeve, ku identifikohet si problematikë zvarritja e gjykimit, si dhe kompetenca lëndore shumë e gjerë e këtyre gjykatave.

6) Tek nënçështja “Mirëqeverisja e Gjyqësorit” përshkruhen:

- KLD, ku identifikohen 17 problematika, të cilat lidhen me përbërjen, organizimin dhe funksionimin. Ka komente për performancën e KLD-së në kundërshtim me ligjin dhe është një qasje diametralisht e kundërt nga ajo e përdorur për institucionet e tjera. Gjithashtu, ka mospërputhje/inkoherencë midis problematikave të renditura në këtë pjesë me ato tek Pjesa “Përmbledhje e Gjetjeve”, ku tek kjo e fundit janë shtuar ndikimi i papërshtatshëm politik në KLD dhe mungesa e vullnetit të saj të mirë për të përmbushur funksionet e saj. Ndërkohë tek Pjesa “Përfundimet” është shtuar edhe fenomeni i korporativizmit për shkak të pjesëmarrjes së 10 gjyqtarëve në KLD.
- Inspektorati i KLD-së, që është trajtuar tek Mirëqeverisja e Gjyqësorit si pjesë e KLD-së. Identifikohen si probleme pasja e dy funksioneve “inspektim dhe vlerësim gjyqtarësh”, mungesa e kuadrit ligjor të statusit të tyre, me mungesë të llogaridhënies dhe procesit disiplinor. Edhe këtu qasja është e ndryshme sepse

- zhvendoset fokusi tek llogaridhënia e kësaj strukture dhe jo tek fuqizimi i saj për të performuar më mirë. Nuk ka kritika të mirëfillta për performancën, por nuk ka një paraqitje reale të veprimtarisë sepse mungojnë tërësisht të dhënat. Ka inkoherencë me Pjesën e Përmbledhjes së Gjetjeve, ku janë shtuar si problematika mbivendosja e inspektimeve, burimet njerëzore dhe kapacitetet profesionale të pamjaftueshme;
- Konferenca Gjyqësore Kombëtare, për të cilën nuk jepet asnjë problematikë. Ka inkoherencë me Përmbledhjen e Gjetjeve, ku përshkruhet si problem dështimi i kësaj Konference për të fuqizuar çështjet e etikës së gjyqtarëve dhe mbrojtjen e interesave të gjyqtarëve;
 - Ministri i Drejtësisë, ku evidentohet roli ligjor i tij si problematikë që ka shkaktuar fragmentarizimin, influencën mbi administratën gjyqësore, mbivendosja e inspektimeve dhe kompetenca ekskuzive e tij për procedimin disiplinor. Justifikohen këto kompetenca si të gjetura në përputhje me Kushtetutën nga Gj.Kushtetuese në vitin 2004. Tek Pjesa e Përmbledhjes së Gjetjeve, kjo problematikë konvertohet në pasaktësi konceptuale dhe ligjore, si dhe si kompetenca jo efektive dhe jo profesionale të Ministrit të Drejtësisë. E njëjta qasje përdoret edhe tek Pjesa e Përfundimeve, ku është mjaftuar me problematikën e fragmentarizimit, mbivendosjes së inspektimeve dhe nismë jo efektive, objektive dhe profesionale e Ministrit për procedimin disiplinor.
 - Inspektorati i MD-së, për të cilin jepet si problematikë vetëm që roli i tij nuk është në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare. Nuk jepet asnjë koment apo kritikë për performancën e tyre, ku duket se çështja është vetëm në nivel ligji, në ndryshim nga Inspektorati i KLD-së, ku evidentohen si probleme burimet njerëzore dhe kapacitetet profesionale apo mungesa e një sistemi të saktë të gjurmueshmërisë së ankesave (kjo e fundit e pasaktë në Analizë).

7) Në nënçështjen “*Mirëqeverisja Gjyqësorit*”, mungon trajtimi për Presidentin e Republikës me kompetenca për numrin e gjyqtarëve dhe kompetencat e gjykatave, për ZABGj me kompetenca në çështje të financimit të sistemit gjyqësor, si dhe për Shkollën e Magjistraturës. Po ashtu, mungon trajtimi i institucionit të kryetarit të Gjykatës dhe të kancelarit, që janë subjektet e qeverisjes së përditshme të gjyqësorit brenda gjykatave të tyre – sidomos roli i kryetarit të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, nuk janë marrë fare në analizë shoqatat e gjyqtarëve, të cilat janë një mekanizëm që duhet të ndikojnë në qeverisjen e gjyqësorit. Po ashtu, ka mungesë të një trajtimi të marrëdhënieve ndërkombëtare (pjesëmarrja në organizatat ndërkombëtare), që duhet të shndërrohet në një shtysë për arritjen e standardeve më të mira në qeverisjen e gjyqësorit.

8) Tek nënçështja “*Statusi i Gjyqtarit*” evidentohen papajtueshmëritë, emërimi në çdo shkallë gjyqësorit, vlerësimi i performancës profesionale dhe etike, palëvizshmëria dhe transferimi, transferimi i përkohshëm, transferimi i përhershëm, promovimi, përgjegjësia disiplinore, mbarimi i mandatit të gjyqtarit, emërimi i gjyqtarëve në institucione të tjera, pagat dhe përfitimet financiare e sociale të gjyqtarit, siguria dhe mbrojtja e gjyqtarit dhe kushtet e punës

9) Kritika kryesore nënçështjen “*Statusi i Gjyqtarit*” lidhet me mungesën e një qasjeje shkencore dhe gjithëpërfshirëse sepse nuk janë përdorur të dhëna dhe raste konkrete. Po ashtu nuk ka një katalog të besueshëm të të gjitha elementeve dhe standardeve ndërkombëtare. Duket që konkluzionet janë hartuar sipas përshtypjeve të përgjithshme, të përfituara nga histori individuale të njëanshme! Për ilustrim, tek problematikat e emërimit

jepet si problem që nuk është zbatuar ligji nga KLD për kandidatin fitues me numër të barabartë votash, po nuk jepet asnjë rast ilustrues. Ky është një tregues që dokumenti, në pjesë të caktuara, është hartuar bazuar në histori personale të veçanta, pa u verifikuar institucionalisht dhe pa analizuar fenomenologjinë e sistemit. Gjithashtu, ka mungesa të informacionit kyç. Për ilustrim, teksta flitet për vlerësimin e performancës profesionale dhe etike, nuk thuhet asgjë për vlerësimin e kryetarëve të gjykatave dhe për vlerësimin e ndihmësve ligjorë, apo edhe mungesa e vlerësimit efektiv të inspektorëve të MD-së. Një ilustrim tjetër është ai i procedimit disiplinor, ku mungon tërësisht analiza e perspektivës së vetë gjyqtarit dhe e garancive që duhet të mbrojnë atë në një procedim disiplinor – një qasje e tillë përdoret në shumë dokumente ndërkombëtarë.

10) Në nënçështjen “*Statusi i Gjyqtarit*” nuk mungojnë as kontradiktat e nivelit teknik. Për ilustrim, ndonëse flitet për mbrojtjen dhe sigurinë e gjyqtarit, paraqitet si problem gjerësia e imunitetit të gjyqtarit në rastet e kontrollit personal dhe të banesës!

11) Tek nënçështja “*Administrimi i gjyqësorit*” flitet për transparencë dhe eficiencë. Edhe në këtë nënçështje mungojnë të dhëna statistikore dhe studime/vlerësime të besueshme të situatës. Aty ku jepen të dhëna statistikore, siç është rasti me punonjësit e administratës gjyqësore, nuk jepet problematikë e performimit të tyre, që është një nga çështjet më shqetësuese. Ka edhe probleme/gabime të nivelit teknik sepse nuk bëhet diferencë midis procesit gjyqësor civil dhe procesit gjyqësor administrativ. Mungojnë problematikat e ICMIS dhe të dështimit të QBZ për publikimin e ligjeve të konsoliduara. QBZ nuk ka përmbushur detyrimin që ka me ligj për përditësimin e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ka edhe pjesë inkohente siç është rasti me gjykimin administrativ, ku tek “Përmbledhja e Gjetjeve” kritikohet kompetenca shumë e gjerë e këtyre gjykatave, ndërsa në këtë nënçështje ngrihet si shqetësim vetëm numri jo i mjaftueshëm i gjyqtarëve.

12) Tek nënçështja “*Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore*” mungon paraqitja reale e reformës së shërbimit përbarimor privat, e cila u miratua në vitin 2008 me perspektivën e zhvillimit tranzicional duke e mbajtur me të dyja shërbimet dhe pas pak kohësh të shndërrohej në një shërbim tërësisht privat. Ky është një tregues tjetër i njëanshmërisë së ekspertëve, të cilët janë ndalur edhe në lëvizje dytësore në sistem të ndodhura në periudhën kohore jashtë 2005-2013. Po ashtu, tek kjo nënçështje mungon analiza kritike e performimit të institucioneve shtetërore të lidhura me ekzekutivin, të përfshira me përgjegjësi në këtë fushë, siç janë MD, Avokatura e Shtetit, Shërbimi i Provës, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme apo Drejtoria e Burgjeve. Për ilustrim, mungon trajtimi i përpjekjeve për të vënë në funksionim mbikëqyrjen elektronike dhe mundësisë që duhet krijuar për shtrirjen e saj në të gjithë Shqipërinë, vecanërisht tek të miturit dhe gratë. Apo, analiza për aplikimin e sistemit “One Stop Shop” në ZRPP që ishte një histori suksesi në luftën kundër korrupsionit dhe që duhet shtrirë në të gjithë Shqipërinë.

13) Në **pjesën IV** “Përmbledhje e gjetjeve” janë përshkruar problematikat e sistemit gjyqësor, por ka devijime të thella midis kësaj pjese dhe pjesës III që përshkruan gjendjen aktuale. Çuditërisht devijimet lidhen vetëm me çështje të funksionimit të KLD-së. Po ashtu, ka edhe doza të vlerësimit të njëanshëm sidomos tek përmbledhja e gjetjeve për KLD apo për Inspektoratin e tij. Përdoren fjalë të tilla si “mungesë e vullnetit të mirë”, “shkelje e ligjit nga KLD” etj.

(Për më shumë mbi këto çështje, lutemi referojuni Pjesës së Tretë, Kreu II, të Versionit të Plotë të Platformës “Mbi Reformën në Drejtësi”).

III. DREJTËSIA PENALE

1) Në Dokumentin e Analizës, çështja e prokurorisë (organizimi, funksionimi, etj) janë përqendruar në kapitullin e Drejtësisë Penale, porse gjurmë, pak ose shumë të rëndësishme, gjenden të shpërndara edhe në kapituj të tjerë. Kjo ndoshta për faktin, se siç është përmendur edhe më sipër, “pushteti gjyqësor” përfshin domosdoshmërisht edhe sistemin e prokurorisë dhe se çdo ndërhyrje në njërin degë (psh në sistemin e gjykatave) jep efektin e vet edhe tek sistemi i prokurorisë. Kjo e bën paksa të vështirë analizën pasi fakti se gjenden trajtime të të njëjtës çështje në një kapitull diku tjetër, trajtimi është i ndryshëm.

2) Trajtimi është akademik dhe pa mbështetje në të dhëna. Prej asaj çka është trajtuar në kapitullin e “drejtësisë penale” konstatohet se pjesa dominuese e materialit trajton një shtjellim sqarues mbi dispozitat ligjore dhe nëpër të janë shprehur edhe probleme sipas pikëpamjes së autorëve ekspertë. Identifikimi i rrethit të problematikave dhe shkalla e thellësisë së tyre mesa duket nuk është bazuar në eksperiencë, studime, statistika - pra të dhëna objektive krahasimore.

3) Materiali përmban një përpjekje të lavdërueshme për të trajtuar jo vetëm çështje të organizimit dhe funksionimit të institucioneve përkatëse të sistemit të ndjekjes penale, porse edhe çështje që ndoshta duken më pak të rëndësishme, siç janë çështjet e perfeksionimit të procedurës hetimore, çështjet e së drejtës materiale penale apo edhe çështjet e marrëdhënieve ndërkombëtare apo edhe ato të sistemit të ekzekutimit të vendimeve. Gjithsesi, edhe për këto çështje konstatohet jo ndonjë trajtim i strukturuar apo tendencë për të adoptuar ndonjë sistem apo model të paracaktuar.

4) Strukturimi i analizës duke iu referuar organeve dhe jo fushës (veprimtarisë), është ndoshta një nga nga arsytet që ka çuar në një analizë jo të thelluar dhe deri diku të deformuar, qoftë përse i përket identifikimit të problematikave, qoftë edhe zgjidhjeve apo edhe vetë diskrepancave që rezultojnë midis problematikave dhe zgjidhjeve në draft-Strategji. Po kështu, edhe përpilimi i analizës duke mos saktësuar setin e akteve ndërkombëtare (standardeve), mbi të cilat duhet të bëhen operacionet logjike krahasimore është një arsye tjetër, që ka shpënë në zgjidhje të papërshtatshme. Zgjidhjet e dhëna nuk godasin thelbin e problemit (cilësinë korrekte të ushtrimit të funksionit të ndjekjes penale), por orientohen tek modulimi i disa procedurave për zgjedhjen e PP apo mekanizmat pjesëmarrës në të. Për pasojë, zgjidhjet e dhëna reflektojnë pa e fshehur ndjesinë e momentit politik të mazhorancës aktuale, kur në të vërtetë duhet të reflektonin nevojat shkencore të reformimit.

5) Në pjesën “1.4.1 Emërimi dhe pozita kushtetuese e prokurorit të Përgjithshëm”, ku theksohet se raportet Kuvend-prokurori kanë patur probleme (komisionet hetimore dhe shkarkimi i PP), konstatohet inkoherencë me pjesën “Përmbledhje e Gjetjeve”, ku evidentohen vetëm disa nga problematikat. Po ashtu, ka inkoherencë me pjesën “Përfundime”, ku problematikat janë rrudhur vetëm tek kriteret e emërimit të PP dhe tek miratimi i kandidatit të tij me shumicë minimale. Është shpikur term i ri legjislativ “shumicë minimale” sepse në fakt Kushtetuta flet për “shumicë të thjeshtë”. Mungon si problematikë pozicionimi jo korrekt i PP në Kushtetutë, që është një model tërësisht shqiptar i pashoq dhe që ka krijuar këto probleme. PP nuk konceptohet në Kushtetutë as si pjesë e pushtetit gjyqësor dhe as si pjesë e ekzekutivit.

6) Nuk ka asnjë argument logjik që mbështet nevojën për trajtim të njëjtë të Këshillit të Prokurorisë, me atë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Delikatesa e këtij propozimi dhe mos-mbështetja në një analizë kushtetuese apo edhe në krahasimin me standarde ndërkombëtare hedh hije dyshimi të forta mbi seriozitetin e deklaramit të kësaj zgjedhjeje si një synim për t'u arritur nëpërmjet reformes kushtetuese. Ndërkohë që ngritja në nivel kushtetues e një organi të tillë, me përbërje siç propozohet dhe më shumë akoma me kompetenca vendimmarrëse, që tejkalojnë edhe figurën qendrore të PP (propozohet të ngjasojë me KLD, pra të ketë fjalën e fundit edhe për emërim apo shkarkim të prokurorëve), duket se vendos në krizë të thellë edhe parashikimin aktual kushtetues të prokurorisë si organ i centralizuar (neni 148/2) dhe parashikimin kushtetues se shkarkimi i prokurorëve bëhet nga PP (neni 149/3), madje edhe vetë modelin e sistemit të prokurorisë.

7) Ka një kontradiktë flagrante midis Dokumentit Analitik teksa konstatohet se kontrolli i prokurorisë mbi policinë është i dobët dhe nevojës për përforsim absolut të tij, dhe sugjerimit në draft-Strategji në Objektivin 3 pika 2 që shkon *drejt dobësimin akoma më tepër të këtij autoriteti*.

8) Lidhur me problematikën e kriterëve që duhet të përmbushë një kandidat, në dokument është bërë referenca që ato të jenë të ngjashme me kandidatët për GjK. Kjo është një zgjedhje pothuajse e paqortueshme. Lidhur me procedurën e emërimit (pra propozimi nga Këshilli i Prokurorisë) kjo duket se është një zgjidhje *“deus ex machina”*. Kjo formulë nuk është trajtuar asfare as në pjesën e *“Analizës Kushtetuese”* e aq më pak në *“Drejtësinë Penale”*. Kjo është një dëshmi që tregon për inkosistenca të rënda midis dy dokumentave dhe seriozitetit të analizës apo edhe procesit të përzgjedhjes së rekomandimeve finale. Aq më pak bëhet fjalë për analizë të standardeve ndërkombëtare në identifikimin e problematikave apo zgjedhjeve.

9) Janë plot 17 problematika, që përmbahen vetëm në pjesën e dokumentit analitik *“Drejtësia Penale”* pjesa e *“Prokurorisë dhe policisë gjyqësore”*, të cilat nuk gjejnë një korrespondues të tyre në draft-Strategji (këtu nuk përmenden pjesët e tjera të Dokumentit Analitik mbi *“Të drejtën procedurale penale”*, *“Të drejtën penale”* apo analiza e përmbajtur tek *“Analiza Kushtetuese”*, *“Pushteti Gjyqësor”* apo *“Masat Antikorrupsion”*). Një mangësi e tillë dëshmon më së paku për një cilësi jo të lartë të hartimit të dy dokumentave, e cila në analizë të fundit, demonstroi se së paku përpilimi i draft-Strategjisë, nuk është produkt i veprimtarisë së një ekspertize të mirëfilltë juridike, dhe se në disa pasazhe duken qartë influenca të natyrës politike.

10) Janë gjithashtu plot 17 rekomandime, të deklaruara në draft-Strategji, të cilat *“kanë mbirë”* në këtë dokument nga *“asgjëja”*. Për to nuk është konsumuar asnjë rresht i vetëm në Dokumentin Analitik, për trajtimin e tyre, për nevojën e parashikimit të tyre, për problematikën që eventualisht paraqet gjendja aktuale apo për modelin apo standadin ndërkombëtar të ndjekur teksa janë përzgjedhur si zgjidhje, për t'u ndjekur përgjatë procesit të draftimit të ndryshimeve ligjore. Kjo mangësi flagrante vendos në krizë jo vetëm seriozitetin e gjithë dokumentit, por edhe dobishmërinë praktike të trajtimit të këtyre zgjidhjeve.

(Për më shumë mbi këto çështje, lutemi referojuni Pjesës së Tretë, Kreu III, të Versionit të Plotë të Platformës “Mbi Reformën në Drejtësi”.)

IV. ANALIZË E MASAVE LIGJORE ANTIKORRUPSION

1) Nuk përmendet në asnjë rresht dhe asnjë citim Raporti i raundit të IV të vlerësimit të Shqipërisë nga GRECO, dokument thelbësor ky, përsa i takon kuadrit ligjor të antikorrupsionit në sistemin e drejtësisë, jo vetëm për natyrën e specializuar dhe fokusin ekskluziv antikorrupsion të GRECO, por vecanërisht për faktin që objekt i raundit të katërt të vlerësimit të GRECO është pikërisht parandalimi i korrupsionit në asamblatë parlamentare dhe në gjyqësor e prokurori. Duke konsideruar edhe natyrën detyruese të rekomandimeve të GRECO, rekomandime për adresimin e të cilave me ndërhyrje në legjislacion Shqipëria do të raportojë, mospërfshirja e gjetjeve dhe rekomandimeve të GRECO në analizë e bën atë jo vetëm thellësisht të mangët, por le hapësirë që në strategji adresimi i këtyre gjetjeve të bëhet jo sipas rekomandimeve dhe standardit më të lartë të KiE, por sipas interesave politike të castit.

2) Në një kohë kur mjaft prej gjetjeve të analizës janë të njëjta me ato që përmbahen në raportin e GRECO trajtimi i tyre është thellësisht i ndryshëm. Trajtimi në raportin e GRECO është ai i vetërregullimit dhe vetëperfeksionimit të sistemit nëmërmjet fuqizimit të mekanizmave të brendshme të gjyqësorit dhe gjetjes së zgjidhjeve praktike brenda sistemit gjyqësor –prokurori, pasi korniza ligjore ekziston. Nga ana tjetër, trajtimi i analizës ka si tendencë që gjetjet mbi problematika të caktuara t'i trajtojë në prizmin e konfliktit, paqartësisë, mungesës, përplasjes së normave, duke synuar të legjitimojë kështu jo vetëm ndërhyrje thelbësore në legjislacion por edhe krijimin e organeve të reja me kompetenca të reja! Ky trajtim i analizës është kontradiktor me një nga gjetjet kryesore të saj, sipas të cilës kuandri ligjor ekzistues është përgjithësisht i plotë dhe i përshtatshëm- konkluzion ky edhe i raportit të Raundit III të vlerësimit të GRECO për Shqipërinë.

3) Nga pikëpamja metodologjike analiza është strukturuar në format akademik, ilustrativ duke konsistuar në një *snapshot* të kuadrit ligjor aktual të luftës kundër korrupsionit në sistemin gjyqësor, institucioneve dhe kompetencave të tyre, dhe më pas duke kaluar menjëherë në evidentimin e problematikave, të cilat janë thjeshtë opinion, të pa bazuara në pjesën dërrmuese në të dhëna të sakta dhe të pakontestueshme.

4) Përsa më sipër analizës i mungon një format logjik për konstatimin e qartë të problematikave duke u nisur nga gjetjet e gjithëpranuara të institucioneve ndërkombëtare (raporti i GRECO- progres raportet e BE- raporte të tjera relevante të cilat analizojnë kuadrin ligjor ekzistues) për të kaluar te kompetencat e institucioneve ekzistues (për të vlerësuar mjaftueshmërinë apo pamjaftueshmërinë e tyre), për të kaluar më pas te një vlerësim objektiv i hallkave të sistemit të cilat kalojnë për shkak të mungesës së kompetencave dhe/ ose mbivendosjes dhe mosndarjes së qartë të kompetencave midis institucioneve.

5) Gjetjet mbi të cilat bazohet analiza nuk janë objektive, të pavarura dhe të bazuara mbi dokumentat ndërkombëtare por ato që në fillim, në pjesën më të madhe të tyre, i referohen për analogji gjetjeve të një raporti të vitit 2009 të KiE për Ukrainën, model reformimi të sistemit të drejtësisë i cili synohet të implementohet edhe në Shqipëri. Ky fakt është jorelevant duke konsideruar se gjetjet në raportin referues (për Ukrainën 2009) janë në masë dhe në peshë specifike të ndryshme nga ato të dokumentave ndërkombëtare përsa i përket Shqipërisë. Si shembull ilustrativ mund të përmendim faktin se në raportin për Ukrainën konsiderohet se një pjesë fare e vogël e të intervistuarve e lidhin

korrupsionin në gjyqësor me pagat e ulëta të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe me mungesën e investimeve dhe kushteve në sistemin gjyqësor, në një kohë kur psh. gjetjet e GRECO në raportin për raundin e IV të vlerësimit e gjejnë këtë fakt si një nga arsyet kryesore të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

6) Analiza nuk merr në konsideratë, ose të paktën nuk merr në mënyrë të shprehur në trajtim, dokumenta të rëndësishëm antikorrupsion si janë Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit dhe për një Qeverisje Transparente 2008-2013, Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020, si dhe gjetjet e rekomandimet e Projektit kundër Korrupsionit në Shqipëri (Projekti PACA).

7) Analiza e sistemit nuk merr në konsideratë pjesë të rëndësishme të legjislacionit antikorrupsion si psh. legjislacioni mbi denoncuesit e korrupsionit *whistleblowers* si dhe iniciativa ligjore në proces në këtë fushë (iniciativa për një ligj të ri për denoncuesit e korrupsionit, iniciativa për ndryshime në ligjin për deklarimin e pasurive etj.) duke mosarritur të krijojë një panoramë të plotë të kuadrit ligjor si dhe evidentimin e arsyeve të keqfunksionimit dhe të mosdhënies së impaktit të duhur, të një pjese të legjislacionit, në praktikë.

8) Analiza e sistemit nuk merr në konsideratë dhe nuk evidenton këndvështrimin e vetë institucioneve relevante të përmendura në të, si aktorë kryesorë të impenjuar në parandalimin, hetimin dhe ndëshkimin e veprave korruptive, të materializuar në analizat e brendshme të punës, evidentimin e vetë problematikave të punës por edhe të synimeve e objektivave të tyre në të ardhmen për perfeksionimin e performancës dhe rritjen e rezultateve.

9) Analiza evidenton si pikë të dobët të sistemit investigimin financiar dhe mosnjohjen e mospërdorimit e tij kryesisht nga ana e strukturave hetuese të korrupsionit vëcanërisht në hetimet proaktive. Nga ana tjetër analiza nuk ndalet në evidentimin e kompetencave, përgjegjësisve dhe funksionimin e një agjencie shumë të rëndësishme në këtë drejtim si është Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, institucion ky thellësisht i politizuar që prej vjeshtës së vitit 2013 e në vijim.

10) Analiza bazohet kryesisht në një ilustrim të kuadrit ligjor ekzistues për parandalimin hetimin dhe gjykimin/ndëshkimin e korrupsionit në duke u nisur nga premisa thjesht akademike të pambështetur shpesh me të dhëna objektive që lidhen më mirëfunksionimin ose jo të normave. Nisur nga këto premisa, shumica e gjetjeve për këtë kre mund të orientohen sipas cdo lloj interesi që synohet të arrihet duke pasur në konsideratë faktin që ato janë thjesht teorike dhe të pambështetura në raporte nga burime të treta. Për shembull që në krye të herës në analizë vihet theksi, mbi konstatimet e GRECO në raportin e raundit III të vlerësimit që përgjithësisht legjislacioni në fuqi është adekuat dhe i përshtatshëm për të luftuar korrupsionin ashtu si edhe kriminalizimi i veprave korruptive. Llogjikisht në vijim analiza duhet të kishte në fokus probleme të zbatimit të legjislacionit në praktikë dhe vëcanërisht kjo e e mbështetur nga raporte ndërkombëtare. Për shumë nga gjetjet dhe konstatimet pranohet se nuk disponohen të dhëna (psh. rasti i ndikimit të ish gjyqtarëve dhe prokurorëve pas përfundimit të detyrës, rastet e heqjes dorë të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të dhëna mbi funksionimin e kodit të etikës së prokurorëve etj...).

(Për më shumë mbi këto çështje, lutemi referojuni Pjesës së Tretë, Kreu VI, të Versionit të Plotë të Platformës “Mbi Reformën në Drejtësi”.)

V. ANALIZË E SISTEMIT TË DREJTËSISË PËR SHËRBIMET LIGJORE

- 1) Dokumenti Analitik më tepër se problematikat, ka bërë një prezantim të gjendjes aktuale të shërbimeve ligjore. Përfshirja në të i informacioneve irelevante (psh. fillesat e profesionit të avokatisë apo përmbarimit gjyqësor) e bëjnë materialin të lodhshëm, duke sjell humbje të fokusit për të cilin është hartuar Dokumenti Analitik.
- 2) Ndërsa në analizë trajtohen avokatia, noteria, përmbarimi gjyqësor, ndërmjetësimi, apo Avokatura e Shtetit, konstatojmë se mungon arbitrazhi, mjekësia ligjore, ZRPP, QBZ, përkthimi zyrtar dhe ekspertët.
- 3) Nuk detajohet procesi i licensimit të avokatëve, tarifat që aplikohen për marrjen e licencës dhe garancitë që ofron procesi i licencimit për të siguruar profesionalizimin e avokatëve.
- 4) Vihet re një tentativë për të fshehur arritjet që ka patur sistemi noterial shqiptar në periudhën 2005-2013.
- 5) Dokumenti Analitik nuk merr në analizë shkencore statistikën mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, për të konkluduar më pas nevojën e shkrirjes apo jo të shërbimit përmbarimor shtetëror, apo për eficientësinë e shërbimit përmbarimor privat.
- 6) Nuk pasqyrohet fakti se nga viti 2012 profesioni i ndërmjetësit ka filluar të ushtrohet në Shqipëri dhe nuk evidentohen problemet që sjellin numrin e ulët të çështjeve që trajtohen/zgjidhen me ndërmjetësim.
- 7) Në Dokument nuk analizohet situata e krijuar në Avokaturën e Shtetit pas vitin 2013, ku pothuajse u shkarkuan nga detyra të gjithë drejtuesit e strukturave profesionale të Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, përfshirë Avokatin e Përgjithshëm.

(Për më shumë mbi këto çështje, lutemi referojuni Pjesës së Tretë, Kreu V, të Versionit të Plotë të Platformës “Mbi Reformën në Drejtësi”.)

VI. MBI ANALIZËN E ARSIMIT JURIDIK

- 1) Analiza është mbështetur në gjetjet aktuale dhe bazohet në ligjin aktual të arsimit të lartë dhe nuk reflekton ndryshimet thelbësore që i bëjnë sistemit arsimor të lartë, praktikisht dhe sistemit univeritar juridik, ligji i ri i arsimit të lartë.
- 2) Dokumenti Analitik në mënyrë të njëzëshme konsideron masivizimin e arsimit të lartë si një problem madhor, duke anashkaluar faktin se ky masivizim ka ardhur kryesisht për shkak të preferencës nga studentet të këtij profili, si dhe rëndësinë që merr ai në shërbim të një edukimit me të plotë juridik të shoqërisë me të drejtat dhe detyrimet.
- 3) Në pjesën që dokumenti analizon raportin pedagogjik të studentëve, kur e bëjnë këtë për Universitetet Private përlogarit në staf dhe pedagogjet e jashtëm, ndërsa për Universitetet Publike nuk i përlogarit pedagogjet e jashtëm, duke mos e pasur të saktë raportin studentëve pedagogjik në rastin e Universiteteve Publike të vendit që ofrojnë degen e Drejtësisë.

4) Dokumenti nuk qarteson se nese Universitetet Private i percaktojne vete kriteret per transferimin e studenteve, Universitetet Publike operojne ne boshlllek ligjor sa i perket mundesise se tranferimeve, duke lene hapsira per abuzime deri ne korrupsion me keto transferime.

(Për më shumë mbi këto çështje, lutemi referojuni Pjesës së Tretë, Kreu IV, të Versionit të Plotë të Platformës “Mbi Reformën në Drejtësi”.)

VII. ANALIZË FINANÇIMIT DHE INFRASTRUKTURËS SË SISTEMIT TË DREJTËSISË

1) Vihet re se merret në analizë vetëm buxheti mbi gjyqësorin, prokurorinë dhe ndihmen juridike, duke analshkualuar buxhetin për aktorët e tjerë të sistemit të drejtësisë, përfshirë sistemin penitenciar apo të mekanizmave të kontrollit të sistemit të drejtësisë.

2) Ndërkohë që lufta kundër korrupsionit dhe paligjshmërisë duhet të jetë prioritet i reformës në drejtësisë, vihet re mungesa e një analize mbi financimin e mekanizmave të kontrollit të sistemit (sic është inspektimi i gjyqësorit apo inspektimi i prokurorisë).

3) Nuk përshkruhet gjendja që ka patur infrastruktura e gjykatave dhe shërbimeve mbështetëse gjatë periudhës 1998 – 2005, ku pothuajse nuk është bërë asgjë në drejtim të përmirësimit të kushteve të punës në gjykata apo infrastrukturës teknologjike në to.

4) Në Dokument nuk sqarohen arsyet që sollën bllokimin e ndërtimit të Pallatit të Drejtësisë me fonde të Bashkimit Europian.

5) Dokumenti Analitik anashkalon faktin se rritja e pagës së gjyqtarëve në vitin 2013 nuk u arrit të aplikohet në masën e parashikuar, për shkak se në të njëjtën periudhë kur ajo pritej të gjente zbatim (viti 2014), Qeveria propozoi dhe Kuvendi miratoi rritjen e tatimit mbi të ardhurat, gjë që pati impakti në mos realizimin e rritjes së pagave të gjyqtarëve në masën e parashikuar.

6) Nuk ka një përlllogaritje të saktë të nevojave buxhetore dhe kostove që ka përmirësimi i kushteve të punës apo statusit të gjyqtarëve/prokurorëve. Kjo mangësi pamundëson hartimin e një strategjie afatgjatë për të përmirësuar infrastrukturën, kushtet e punës apo statusin e gjyqtarëve/prokurorëve. Financimi i drejtësisë është mbi të gjitha çështje kostoje dhe mungesa e një përlllogaritje të saj dhe nevojave të sistemit, duket të mos krijojë premisë solide për zgjidhjen e problemit.

(Për më shumë mbi këto çështje, lutemi referojuni Pjesës së Tretë, Kreu VII, të Versionit të Plotë të Platformës “Mbi Reformën në Drejtësi”.)

KREU III – MASA TË PROPOZUARA NË PLATFORMË SI ZGJIDHJE STRATEGJIKE PËR PROBLEMATIKAT

Për të gjitha problematikat e evidentuara në Dokumentin Analitik apo masat e propozuara në Strategji, për të cilat në këtë Platformë nuk jepen komente apo nuk ofrohet një zgjidhje/propozim alternativ, mbajmë qëndrimin se jemi dakord me ekzistencën e problematikës dhe masat e propozuara. Ndërkohë, në vijim të trajtimit të bërë më sipër në këtë Platformë, problematikave të evidentuara nga ana jonë në sistemin e drejtësisë, si dhe gjetjes së zgjidhjeve mbi këto problematika, në përputhje me standardet ndërkombëtare, vlerësojmë të nevojshme, që të ndara sipas fushave, të ndërmerren këto masa apo të ndiqen këto rekomandime:

I. REFORMA E KUSHTETUTËS PËR SISTEMIN E DREJTËSISË DHE REFORMA E GJYKATËS KUSHTETUESE

1.	Reforma në Drejtësi është sektoriale dhe nuk duhet të synojë reformimin e organizimit shtetëror në tërësi. Një zgjidhje e kundërt mbart rrezikun për nevojën e rishikimit të tre pushteteve, që passjell edhe diskutimin mbi nevojën e një Kushtetute të re. Për këtë arsye, normat kushtetuese të Presidentit të Republikës duhen trajtuar si çështje periferike të Reformës në Drejtësi, për ato pjesë që kompetencat e tij lidhen me sistemin e drejtësisë.
2.	Të mos ndryshojë formula e përzgjedhjes së Presidentit të Republikës.
3.	Të saktësohen kompetencat dhe procedurat respektive të autoriteteve shtetërore në procesin e dhënies së pëlqimit për emërimin/shkarkimin e organeve të sistemit të drejtësisë.
4.	Reforma kushtetuese për GjK duhet të forcojë pavarësinë institucionale të saj në të paktën 4 komponentë: <ul style="list-style-type: none"> a. pavarësinë administrative; b. pavarësinë financiare; c. pavarësinë vendimmarrëse; dhe d. pavarësinë e përcaktimit ekskluziv të juridiksionit.
5.	Reforma kushtetuese për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të GjK duhet të synojë identifikimin e: <ul style="list-style-type: none"> a) Vlerave të demonstruara të kompetencës më të lartë profesionale të gjyqtarëve që zgjidhen; b) Përvojës së tyre të spikatur në veprimtarinë publike; c) Njohjes së thellë prej tyre të veprimtarisë publike; d) Përvojës dhe kulturave profesionale të diversifikuara; e) Integritetit moral më të lartë; f) Aftësive maksimale për t'u përfshirë, diskutuar dhe angazhuar në çështje të interesit publik.
6.	Zgjedhja e anëtarëve të GjK duhet të realizohet nëpërmjet një mekanizmi ndërveprimi institucional, i cili të përfshijë aktorë jopolitikë dhe politikë me qëllim gërshetimin e komponentit profesional dhe meritokratik nga njëra anë dhe komponentit publik për dhënien e legjitimitetit demokratik nga ana tjetër.
7.	Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të GjK duhet të garantojë: <ul style="list-style-type: none"> - transparencën maksimale që në fazat paraprake;

	<ul style="list-style-type: none"> - shtrirje të mjaftueshme në kohë për secilën hallkë të procesit; - publikim të detajuar për secilën nga vendimmarrjet e ndërmjetme; - aksesin maksimal dhe jo paragjykes për këdo që mendon se përmbush kriteret; - administrim të procesit në instancë të parë nga një korpus ekzistues profesionistësh, me përbërje të diversifikuar dhe jashtë influencës politike, (psh KLD ose vetë GjK) i cili menaxhon: <ul style="list-style-type: none"> i. pritjen e aplikimeve; ii. ekskluzivisht konkurrimin me jetëshkrime, dokumente dhe me intervista; iii. vlerësimin mbi përmbushjen ose jo të kushteve skualifikuese, si dhe përpilimin e vlerësimit objektiv (individual dhe krahasimor) ndërmjet kandidatëve që përmbushin kriteret kualifikuese; iv. plotësimin e dokumentacionit përkatës për secilën kandidaturë të kualifikuar dhe përcjellja tek organi propozues. - në instancë të dytë, propozim të mirë-arsyetuar mbi përzgjedhjen ose jo dhe renditjen përkatëse të kandidaturave të përzgjedhura sipas një vlerësimi objektiv mbi parametra të integritetit moral, njohjes së spikatur të veprimtarisë publike, përvojave dhe kulturave profesionale të diversifikuara, aftësive maksimale për t'u përfshirë, diskutuar dhe angazhuar në çështje të interesit publik, të një numri minimal kandidaturash për secilin post në GjK, nga grupi i kandidaturave që kanë kaluar fazën e parë. - në instancë të tretë, realizim të seancave dëgjimore publike me kandidaturat e propozuara pa të drejtë skualifikimi - miratim në çdo rast me shumicë prej 2/3 prej Kuvendit, ose në alternativë, me pjesëmarrje substanciale të opozitës, i pasuar nga një mekanizëm zhblllokues në rast ngërci. <p>Të rritet roli i vetë GjK në procesin e zgjedhjes së Kryetarit, duke i njohur vetë asaj zgjedhjen e Kryetarit.</p>
8.	<p>Të forcohet pavarësia individuale me qëllim që gjyqtari i GjK të mos i nënshtrohet influencës politike dhe të jetë i paanshëm nëpërmjet synimit të këtyre 4 komponentëve:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Emërimi i gjyqtarëve të bazohet në kriteret objektive dhe të shmangë njëanshmërinë apo diskriminimin e kandidatëve; b) Siguria e qëndrimit në detyrë dhe e trajtimit financiar, sipas të cilit kërkohet që mandati i qëndrimit në detyrë të jetë i përcaktuar në Kushtetutë dhe t'u garantohet pagë e përshtatshme, si dhe kushte pune dinjitoze c) Të garantohet pushteti vendimmarrës; d) Të saktësohet rrethi i të drejtave të gjyqtarëve; e) Kushtet dhe kriteret e emërimit të gjyqtarëve kushtetues të jenë si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> ✓ Shtetësia; ✓ Integriteti moral; ✓ Njohuritë dhe aftësitë ligjore; ✓ Përvoja profesionale; ✓ Temperamenti gjyqësor; ✓ Përkushtimi në detyrë; ✓ Shëndeti fizik dhe mendor; ✓ Përgjegjshmëria financiare. <p><i>(Përvoja profesionale të mbajë në konsideratë rrezikun e riciklimit nëpërmjet</i></p>

	<i>promovimit të funksionareve, hetuesve, prokuroreve dhe gjyqtareve të regjimit komunist, të cilët duhet të jenë të përjashtuar nga cdo promovim nëse kanë ushtruar keto detyra gjatë periudhës komuniste).</i>
9.	Të mos ndryshojë rregulli për zgjatjen e mandatit të gjyqtarit kushtetues deri në zëvendësimin e tij. Për të shmangur kohëqëndrimin e paarsyeshëm në detyrë përtej mandatit, të caktohen afate për zëvendësimin e gjyqtarit dhe një mekanizëm zhblllokues në rastet kur autoritetet përzgjedhëse dështojnë për një kohë të gjatë të emërojnë gjyqtarin zëvendësues.
10.	Respektimi i institutit të rotacionit të garantohet nëpërmjet saktësisë së kohëzgjatjes së mandatit, afateve të procedurave ripërtëritëse, prezantimit të mekanizmit përzgjedhës të anëtarëve të GjK shoqëruar me mekanizëm të përshtatshëm zhblllokues.
11.	Procesi dhe vendimmarrja disiplinore e gjyqtarëve kushtetues t'i mbetet GjK.
12.	Të saktësohen në nivel kushtetues konceptet e “shkarkimit nga detyra” dhe të “lirimit nga detyra”. Të parashikohet hipoteza e shkarkimit nga detyra e gjyqtarit kushtetues edhe në rastin kur ai procedohet penalisht për një krim të dukshëm, ndonëse vendimi gjyqësor i fajësisë ende nuk ka marrë formë të prerë.
13.	Të plotësohet/zgjerohet rrethi i subjekteve që legjitimohen për t'iu drejtuar GjK për çështje të antikushtetutshmërisë së akteve normative në mënyrë abstrakte, duke ia njohur këtë të drejtë edhe individëve/personave juridikë. Të njihet ky legjitimim edhe për aktet administrative apo çdo sjellje tjetër antikushtetuese, me kushtin që ky legjitimim të bazohet vetëm për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të individit.
14.	Marrëdhënia individ/person juridik-GjK të modulohet në procedurë dhe substancë sipas marrëdhënies aktuale individ-GjEDNj, me qëllim vendosjen e një lineariteti harmonik dhe një raporti subsidiar midis GjK-GjEDNj.
15.	Të përcaktohet shprehimisht në Kushtetutë parimi i sigurisë juridike, si dhe detyrimi i shprehur i GjK për të patur një jurisprudencë konsistente dhe për t'iu referuar në zgjidhjen e çështjeve edhe parimeve të KEDNj.
16.	Të mos zgjerohet rrethi i subjekteve të legjitimuara për çështje të zgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë së Presidentit në GjK.
17.	Të mos shtohet kryetari i KLSH si subjekt që i drejtohet GjK.
18.	Lidhur me legjitimimin e individit në GjK, të parashikohet një përjashtim nga kërkesa për shterimin e mjeteve të brendshme për rastet kur respektimi i këtij rregulli mund të shkaktojë dëme të pariparueshme për individin apo personin juridik.
19.	Legjitimi i Avokatit të Popullit në GjK të parashikojë kushtin që ai, paraprakisht, të kryejë një procedurë të vetën administrative për verifikimin e problemit kushtetues, me nismën e tij ose me ankesë, si kusht legjitimues për në GjK. T'i njihet kjo e drejtë <i>mutatis mutandis</i> , sipas kompetencës funksionale, edhe Autoriteteve të tjera të pavarura që kanë kompetencë liri dhe të drejta themelore të njeriut.
20.	Të rishikohen afatet për kërkesat në GjK, duke siguruar në të njëjtën kohë aksesin në GjK dhe sigurinë juridike. Të përfshihet në këtë rishikim afati edhe kontrolli incidental, si dhe procedura konkrete që ndiqet në gjykata për të.
21.	Të parashikohen procedurat e kontrollit kushtetues të shpërndarjes së organeve të qeverisjes vendore.
22.	Të saktësohet koncepti “bashki” dhe “komunë” nën projeksionin e reformës territoriale.

23.	Dhënia e pëlqimit për ndalimin ose arrestimin e anëtarit të GjK në një proces penal të rregullohet sipas standardeve të Komisionit të Venecias. Në këtë procedurë, të parashikohet që gjyqtari kushtetues mund të pezullohet nga detyra, që vendimi të meret me shumicë të të gjithë gjyqtarëve të GjK, pa pjesëmarrjen e gjyqtarit të interesuar. Pezullimi të parashikohet për procedime penale për vepra penale shumë të rënda.
24.	Të harmonizohet kompetenca e Kolegjit Zgjedhor me kompetencën e GjK për çështje të zgjedhshmërisë së deputetëve. Detajet e kësaj çështjeje duhet të jenë pjesë e Reformës Zgjedhore.
25.	Në rastet e ankimit të individit në GjK për zvarritje, GjK duhet të mundësojë urdhërimin e përfundimit të përsheptuar të procedurës përpara gjykatës së zakonshme ose të vendosë vetë mbi meritat e çështjes. Në këto lloj çështjesh, GjK duhet të jetë në gjendje të sigurojë një kompensim të barabartë me atë që ankuesi do të merrte nga GjEDNj.
26.	Pas tërheqjes së një ankimi, GjK duhet të jetë në gjendje të vazhdojë shqyrtimin e çështjes, nëse ky shqyrtim është në interesin publik, edhe pse ankuesi nuk është më palë në proces. Të ndahen më vehte procedura e gjykimit të kontrollit kushtetues të ligjeve rishikuese të Kushtetutës nga procedura për kontrollin kushtetues të ligjeve të tjera.
27.	Në rastin e ankimit individual, procesi gjyqësor në GjK duhet të sigurojë riparimin e të drejtës nëpërmjet një vendimi detyrues mbi çështjen. Gjykata duhet të detyrohet të dëgjojë rastin dhe nuk duhet të ketë ndonjë kërkesë të paarsyeshme mbi tarifën apo përfaqësimin.
28.	Të saktësohet njëherë e përgjithmonë se shpallja e vendimit është pjesë e gjykimit dhe se në asnjë rast, GjK dhe çdo gjykatë nuk mund të shpallë vendimin pa arsyetim. Në këtë rast, duhet të përcaktohet afate detyruese jo vetëm për shpalljen dhe arsyetimin e vendimit, por edhe për përfundimin e shqyrtimit të çështjes.
29.	Të qartësohet efekti <i>ex tunc</i> i vendimeve të GjK duke e konceptuar atë vetëm si rrethanë përjashtimore.
30.	Të qartësohet në Kushtetutë se të gjitha organet e tjera shtetërore, përfshi edhe gjykatat, duhet të zbatojnë/ndjekin interpretimin kushtetues të bërë nga GjK. Për këtë qëllim të parashikohen sanksione të forta ndaj zyrtarëve/institucioneve përgjegjëse në rast se vetë GjK, nëpërmjet një procedure të veçantë, të nisur nga subjekti ankues konstaton moszbatim pa shkaqe të vendimit të saj.
31.	Të rregullohen të gjitha çështjet e statusit të ndihmësit ligjorë, deri tek shkarkimi i tyre nga detyrë, duke mbajtur të njëjtën qasje për funksionarët shtetërorë.
32.	Të parashikohet mundësia për vendosjen e tarifave për paraqitjen e kërkesës në GjK. Niveli i tyre duhet të jetë relativisht i ulët dhe GjK të jetë në gjendje të bëjë përjashtimin për njerëzit që nuk kanë mjetet e duhura financiare dhe kur kërkesa nuk është haptazi e pabazuar.
33.	Gjykata e Lartë të shndërrohet në gjykatë karriere dhe jashtë influencave politike.
34.	Të ravigjëzohet një dallim i qartë midis procedurave dhe kritereve për emërimin e gjyqtarëve të GjL, nga procedurat dhe kriteret e emërimit të GjK.
35.	KLD të rikonfigurohet duke synuar garantimin qoftë të pavarësisë së sistemit gjyqësor, qoftë pavarësinë individuale të gjyqtarëve. Detyrë e Këshillit të jetë garantimi, nga çdo presion i jashtëm apo paragjykim i natyrës politike, ideologjike ose kulturore, i lirisë së pakufizuar të gjyqtarëve për të zgjidhur çështjet në mënyrë të paanshme, bazuar në ndërgjegjen e tyre mbi interpretimin

	e fakteve dhe në përputhje me ligjin.
36.	Në Kushtetutë duhet të përcaktohet jo vetëm ngritja e Këshillit, por të përcaktohet edhe rrethi i funksioneve, sektorët nga të cilët vijnë anëtarët e tij, si dhe kriteret dhe procedura e përzgjedhjes së tyre.
37.	Këshilli të ketë kompetencë promovimin e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë, si dhe të forcojë besimin publik tek sistemi i drejtësisë. Për këtë qëllim, ai të ketë detyrën të krijojë mjetet e nevojshme për të vlerësuar sistemin e drejtësisë, për të raportuar për gjendjen e shërbimeve, si dhe për t'i kërkuar autoriteteve përkatëse të ndërmarrin hapat e nevojshme për të përmirësuar administrimin e drejtësisë.
38.	Kompetencat e Këshillit duhet të përfshijnë minimalisht: <ul style="list-style-type: none"> a) Përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve; b) Promovimin e gjyqtarëve; c) Vlerësimin e veprimtarisë së gjyqtarëve d) Trajtimin e çështjeve disiplinore dhe etike e) Trajnimin profesional të gjyqtarëve; f) Kontrollin dhe administrimin e buxhetit të gjyqësorit; g) Administrimin dhe menaxhimin e gjykatave; h) Mbrojtjen e imazhit të gjyqtarit i) Dhënien e mendimit organeve të tjera të pushtetit për çështje që lidhen me sistemin gjyqësor j) Bashkëpunimin me trupa të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë; k) Përgjegjësinë ndaj publikut për transparencën, llogaridhënien dhe raportimin l) Menaxhimin e burimeve financiare për administrimin e drejtësisë; m) Shqyrtimi i ankesave për gjyqtarët dhe gjykatat; n) Hartimin e një raporti vjetor për gjendjen e sistemit gjyqësor mbi veprimtarinë e tij për t'ia prezantuar Komisionit të Ligjeve në Kuvend, si dhe publikut. Ky Raport nuk duhet të shërbejë si shkak për përgjegjësi disiplinore të ndonjë anëtari të KLD-së.
39.	Numri i anëtarëve të Këshillit të përcaktohet bazuar tek volumi i kompetencave, përmbushja efektive e tyre dhe dimensionet e sistemit gjyqësor.
40.	Përbërja e KLD-së të jetë mikse (gjyqtarë dhe jo-gjyqtarë), duke synuar shfaqjen e perceptimit të korporativizmit, vetëmbrojtjes dhe klientelizmit.
41.	Të përcaktohet në Kushtetutë se mazhoranca substanciale e anëtarësisë të KLD-së të jetë nga radhët e gjyqësorit, të zgjedhur prej Konferencës Gjyqësore Kombëtare, që është mbledhja e të gjithë gjyqtarëve të Republikës. Anëtarët gjyqtarë të zgjidhen duke garantuar përfaqësimin e të gjitha niveleve të gjyqësorit.
42.	Me qëllim depolitizimit të Këshillit dhe për të minimizuar çdo rrezik të dëmtimit të besimit publik tek gjyqësori, duhet që konkurrimi për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë të jetë në përputhje me rregullat e vendosura nga vetë Këshilli. Të shmangët pjesëmarrja e Parlamentit, ekzekutivit apo pozicioneve administrativo-hierarkike të sistemit gjyqësor në procesin e zgjedhjes së anëtarëve gjyqtarë. Anëtarët gjyqtarë të vijnë në KLD me anë të një procesi zgjedhor.
43.	Anëtarët e KLD-së duhet të zgjidhen bazuar në kriteret e aftësisë profesionale, përvojës, njohurive të jetës gjyqësore, aftësive për të diskutuar dhe kulturës së pavarësisë.

44.	Anëtarët jo-gjyqtarë duhet të zgjidhen ndërmjet juristëve të spikatur, profesorëve të së drejtës, me një masë përvojë domethënëse në shërbimin profesional ose qytetarë me një status të njohur. Krite shtesë për këta anëtarë duhet të përcaktohen në varësi të llojit të funksioneve që do t'i jepen Këshillit.
45.	Në procesin e zgjedhjes për anëtarë jo-gjyqtarë të KLD-së duhet garantuar që paanësia politike e tyre duke i kufizuar mundësinë shumicës të ketë influencë në përbërjen e Këshillit. Formulatat e propozuara nga komisioni i Venecias që garantojnë pjesëmarrje substanciale të paleve politike në votimi, shoqëruar nga rregulla procedurale ndaj rrezikut të bllokimit, mund të jenë opsione që duhet të vendosen në Kushtetute.
46.	Funksionimi i KLD-së me përbërje mikse nuk duhet të tolerojë ndërhyrjen e mazhorancave parlamentare dhe presionin nga ekzekutivi, si dhe të jetë i lirë nga çdo nënshtrim prej konsideratave politiko-partiake.
47.	Është e preferueshme që anëtarët e KLD-së, me përjashtim të atyre <i>ex officio</i> , të jenë me kohë të plotë.
48.	Disa prej detyrave që lidhen ngushtë me statusin e gjyqtarit duhet të jenë në kompetencë vetëm të anëtarësisë së Këshillit që vjen nga radhët e gjyqësorit.
49.	Formula e zëvendësimit të anëtarëve të KLD-së të garantojë vazhdimësinë e veprimtarisë së Këshillit, duke mos i zëvendësuar të gjithë anëtarët në të njëjtën kohë;
50.	Anëtarët e Këshillit nuk duhet të merren me jetë aktive politike, nuk duhet të kenë qene deputetë, anëtarë të Qeverisë, drejtues të lartë të administratës publike apo ish funksionare, hetues, gjyqtarë e prokurorë në kohën e diktaturës komuniste. Ministri i Drejtësisë nuk duhet të jetë anëtar i KLD-së
51.	Presidenti i Republikës, përsa kohë nuk ka funksione ekzekutive, duhet të vijojë të jetë anëtar i KLD-së; Prania në KLD gjatë procesit disiplinor dhe promovimit mund të eliminohet.
52.	Anëtarët e KLD-së të kenë garanci të shprehura për pavarësinë dhe paanësinë në ushtrimin e detyrës. Shpërblimi i tyre të jetë në përputhje me pozicionin e tyre dhe me ngarkesën e punës në Këshill;
53.	Qëndrimi në detyrë i anëtarëve të KLD-së të jetë i garantuar. Ndryshimet në Qeveri ose në Parlament nuk duhet të influencojnë vazhdimësinë e mandatit të anëtarëve të zgjedhur të KLD-së. Ato mund të influencojnë emërimin ose mbarimin e mandatit vetëm të anëtarëve <i>ex officio</i> ;
54.	Të ndalohet rizgjedhja e menjëhershme e anëtarëve, duke përcaktuar kohën minimale të këtij ndalimi.
55.	Në funksion të përbërjes dhe të kompetencave të KLD-së, të rikonceptohen në mënyrë strikte dhe të saktë kompetencat e Ministrit të Drejtësisë lidhur me sistemin e drejtësisë.
56.	Të MOS suprimohet Konferenca Gjyqësore Kombëtare, por të sigurohet forcimi dhe konsolidimi i mëtejshëm i këtij organi.

II. PUSHTETI GJYQËSOR

57.	Riorganizimi i gjykatave në RSh duhet të bazohet në kriteret e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> a) Shpërndarja e popullsisë; b) Distancat gjeografike dhe aksesueshmërinë në transportin publik; c) Ekzistencën dhe aksesueshmërinë (dixhitale) në infrastrukturën dhe/ose shërbimet mbështetëse;
-----	---

	<p>d) Numrin e mjaftueshëm të çështjeve për të lejuar përdorimin eficient të gjykatave;</p> <p>e) Numrin e përshtatshëm të gjyqtarëve dhe të stafit të tyre mbështetës për të garantuar vazhdimësinë në rastet e sëmundjeve apo të mungesave të tjera të gjyqtarëve, si dhe për të lejuar për specializimin që vlerësohet i nevojshëm në çdo gjykatë (aspekti i cilësisë).</p> <p>f) Garancite e duhura për të statusin dhe palevizshmerinë e gjyqtarëve pa pelqimin e tyre</p> <p>g) Ndalimin e hyrjeve në gjyqësor nga jashtë Shkolles së Magjistratures</p>
58.	<p>Riorganizimi me përqëndrim i gjykatave të bazohet në një studim të mirëfilltë në drejtimet e mëposhtme:</p> <p>a) nevoja për të siguruar drejtësi me cilësi të lartë dhe për të përdorur efektivisht burimet e disponueshme;</p> <p>b) nëse kursimi i kostove arrihet nëpërmjet përqëndrimit të gjykatave, duke vendosur edhe kalendare të objektivave të shtrirë në disa vite;</p> <p>c) mundësinë për përdorimin e shtuar të teknologjive të informacionit dhe të komunikimit (ITC) për të ulur frekuencën e vizitave të nevojshme të palëve personalisht në gjykata, si dhe për përdorimin e ITC edhe për të rritur vizibilitetin e procedurave gjyqësore.</p>
59.	<p>Për KLD, duhet të përcaktohet në ligj detyrimi i këtij Këshilli për të treguar shkallën më të lartë të transparencës ndaj gjyqtarëve dhe shoqërisë duke ndjekur procedura të paracaktuara dhe duke dhënë vendime të arsyetuara.</p>
60.	<p>Në funksion të rritjes së pavarësisë dhe autonomisë vetrregulluese të sistemit gjyqësor, të parashikohet të ketë vetëm një Inspektorat për gjyqësorin, i cili të mbetet brenda KLD-së.</p>
61.	<p>Inspektorati i KLD-së të organizohet në seksione të ndara, përgjegjëse për disiplinimin dhe vlerësimin e gjyqtarëve, për të siguruar ndarjen e nevojshme të këtyre dy proceseve.</p>
62.	<p>Të forcohet Inspektorati, si strukturë brenda KLD-së, duke marrë masat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krite rigoroze për rekrutimin e inspektorëve; - Formulë objektive dhe transparente për emërimin e tyre, <u>duke shmangur në çdo rast ndikimin politik të ekzekutivit apo të Kuvendit, qoftë edhe në mënyrë indirekte;</u> - Dhënie e një statusi të plotë dhe atraktiv (në të gjithë komponentët) inspektorëve për të mundësuar thithjen e burimeve njerëzore më të mira; - Përmirësimin e procedurave të punës, duke u mbështetur në përvojën e fituar, me qëllim zhdërvjelltësimin e saj dhe jo zerimin e saj.
63.	<p>Të garantohet me ligj transparenca e veprimtarisë së KLD-së me anë të mjeteve të tilla si Raporti Vjetor apo publikimi i procesverbaleve apo akteve vendimmarrëse, por duke respektuar standardet e mbrojtjes së të dhënave personale.</p>
64.	<p>Të parashikohet kontrolli gjyqësor (në procedurë dhe në përmbajtje) i vendimeve të KLD-së, duke përcaktuar një zgjidhje uniforme për mjetin e ankimit dhe gjykatën ku paraqitet ankimi.</p>
65.	<p>Të forcohet administrata e KLD-së, duke përfshirë në të departamentet e analizës, të vlerësimit dhe të studimit të sistemit. Të fuqizohet edhe departamenti të teknologjisë së informacionit. Kjo çështje duhet parë e lidhur</p>

	ngushtë me rikonceptimin e kompetencave të KLD-së dhe me buxhetimin e përshtatshëm të saj.
66.	Të rivlerësohet roli i Ministrisë të Drejtësisë në dritën e kompetencave të reja që do t'i jepen KLD-së, duke e zhveshur atë nga disa kompetenca mbi vlerësimin e performancës së sistemit, për pronësinë e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve apo mbi mbledhjen dhe përpunimin e statistikave gjyqësore.
67.	Të rikonceptohet roli i Ministrisë të Drejtësisë për administratën gjyqësore, sidomos për ndihmësit ligjorë.
68.	Të prezantohen në ligj mekanizma të bashkëpunimit ndërinstitucional (përmes rregullave për marrjen e detyrueshëm të mendimit në rastin e hartimit të projekt-akteve ligjore apo strategjive, për raportimet periodike dhe shkëmbimin periodik të informacionit).
69.	Tek Statusi i Gjyqtarit, të rishikohet ndalimi normativ për gjyqtarët, duke lejuar angazhimin e tyre në aktivitete jashtë funksioneve të tyre zyrtare. Për të shmangur konfliktin e interesave, faktik apo të perceptuar, pjesëmarrja e tyre duhet të kufizohet në aktivitete të pajtueshme me pavarësinë dhe paanësinë e tyre.
70.	Për reformimin e Gjykatës së Lartë jepen rekomandimet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> a) GjL të ridimensionohet si një organ qartësisht gjyqësor jo vetëm në funksionim (gjykatë ligji) por edhe në konstituim (gjykatë karriere); b) reformimi i GjL të ketë si objektivi mbi të gjitha profesionalizmin, së bashku me pavarësinë e tejskajshme dhe paanësinë, e sigurisht edhe efikasitetin në veprimtari. Çdo ndikim politik mbi të duhet të evitohet; c) përzgjedhja e gjyqtarëve të GjL, duhet të bëhet ekskluzivisht nga radhët e personave që gëzojnë statusin e gjyqtarit (gjyqtarë efektivë apo gjyqtarë që shërbejnë në struktura të tjera jashtë sistemit gjyqësor); d) nuk duhet të ketë trajtim të diferencuar të llojeve të kritereve të emërimit të gjyqtarëve të GjL krahasuar me llojet e kritereve të emërimit apo promovimit për gjyqtarët e shkallës së parë apo të apelit; e) kriteret e emërimit për gjyqtarët e lartë, por edhe për promovimin e gjyqtarëve në përgjithësi duhet të perfeksionohen. Për më shumë detaje për kriteret e emërimit, të shihet informacioni mbi kriteret e emërimit të gjyqtarëve të GjK në pjesën e Platformës për Ndryshimet Kushtetuese; f) Këshillit për Emërimet në GjL duhet të suprimohet, pasi nuk ka bazë kushtetuese për ngritjen e tij dhe ai nuk ka tiparet e pavarësisë, paanësisë dhe të besimit publik; g) Nëse do të zgjidhet të ruhen gjurmë nga sistemi aktual (Presidencë-Kuvend), me qëllim të eliminimit të politizimit të procedurës së emërimit, të ndërfitet roli i fortë dhe determinant të KLD, jo vetëm si një organ, i cili menaxhon fazat fillestare dhe kryesore të procesit të emërimit, porse edhe si mekanizëm zhblllokues.
71.	Të miratohet pa vonesë projektligji për vlerësimin profesional të gjyqtarëve i depozituar në Kuvend, për të përmirësuar ndjeshëm këtë proces në drejtim të shpejtësisë dhe të cilësisë së kritereve matëse.
72.	Për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit, kohëzgjatja në detyrë e gjyqtarit të garantohet deri në moshën e detyrueshme të pensionit ose deri në përfundim të mandatit, për gjyqtarët me mandat.

73.	Në rast pezullimi, gjyqtarit duhet t'i sigurohet një nivel prej 70 % të pagës, që garanton minimumin e neojshëm jetik të tij dhe familjes.
74.	Parimi i palëvizshmërisë së gjyqtarit dhe rastet përjashtimore të tij të përcaktohen shprehimisht në Kushtetutë, duke e lidhur me pavarësinë e gjyqësorit (përmbajtja aktuale e normës kushtetuese është e pamjaftueshme).
75.	Në rastin e shkarkimit të gjyqtarit apo të transferimit të tij nga detyra, me anë të një procesi disiplinor, duhet të përcaktohen saktësisht në ligj sjelljet që përbëjnë shkelje disiplinore me një pasojë të tillë.
76.	Dalja e hershme e gjyqtarit në pension duhet të bëhet vetëm me kërkesë të gjyqtarit ose kur ka shkaqe mjekësore.
77.	Gjyqtari nuk duhet të marrë një emërim të ri ose të lëvizet në një detyrë tjetër gjyqësore pa pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të sanksioneve disiplinore.
78.	Gjyqtari, mund të transferohet me detyrim, pa pëlqim, në raste përjashtimore në rrethana të përcaktuara shprehimisht në ligj, duke përfshirë sanksionin disiplinor ose rastet e vërtetuara të paaftësisë për të përmbushur funksionet gjyqësore në mënyrë të përshtatshme, të pavarur dhe të paanshme (marrëdhënia e afërt me avokatët apo gjyqtarët që trajtojnë të njëjtat çështje).
79.	Shkaqet për transferimin e gjyqtarit të përcaktohen qartësisht dhe që një transferim i detyrueshëm të vendoset me mjete të procedurave transparente të zhvilluara nga KLD dhe vendimet e tilla të jenë të ankimueshme.
80.	Shkaqet përjashtimore të palëvizshmërisë të vlerësohen nga KLD nëpërmjet një procedure që përmbush kriteret e procesit të rregullt dhe vendimet e tij të jenë të ankimueshme në gjykatë. Rishikimi në këtë rast të përfshijë plotësisht çështjet e procedurës dhe të themelit të çështjes.
81.	Një gjyqtar që punon në një gjykatë që do të shkrihet, duhet të lejohet të vazhdojë punën në një gjykatë të të njëjtit lloj apo të ngjashëm dhe shkallë. Është e rëndësishme që gjyqtari të mos emërohet në një pozicion më të ulët pas shkrirjes së gjykatës.
82.	Në rastin e një reforme organizative – duhet të ketë rregulla të qarta dhe proporcionale për këto transferimin e gjyqtarit, si dhe për të drejtën e apelit. Për këtë është e rëndësishme në kontekstin shqiptar të përkufizohet koncepti i reformës organizative gjyqësore. Termi 'riorganizim gjyqësor' është shumë i gjerë dhe duhet të zëvendësohet me konceptin "riorganizim i sistemit të gjykatave", duke dhënë edhe përmbajtjen materiale të konceptit. Në transferimin e gjyqtarit në këto raste, duhet të ketë rregulla më ligj që gjyqtari të ruajë të njëjtën pagë.
83.	Delegimi i gjyqtarit në një gjykatë tjetër duhet të jetë i mundur vetëm nën kritere strikte qartësisht të identifikuar në ligj (numri i çështjeve tek gjykata pritëse, numri i çështjeve tek gjykata dërguese, numri i çështjeve të gjykuara nga gjyqtari që po caktohet). Gjithashtu, maksimumi i kohëzgjatjes së këtij delegimi duhet të tregohet në ligj.
84.	Në rastin e riorganizimit të sistemit të gjykatave, gjyqtari duhet të marrë më shumë se një propozim për transferim dhe planet për gjyqtarët që dalin në pension në gjykatat e tjera duhet të konsiderohen në bërjen e propozimeve të tilla. Në vend të shkarkimit të gjyqtarit, ai duhet të transferohet pa pëlqimin e tij. Nëse gjyqtari më pas nuk paraqitet në detyrën e re, atëherë mund të fillojë procesi disiplinor i tij jo për shkakun se ai ka refuzuar transferimin e tij, por sepse ka refuzuar të punojë.
85.	Vlerësimi profesional duhet t'i nënshtrohet edhe veprimtaria e ndihmësve ligjorë në gjykata dhe veprimtaria drejtuese e kryetarëve të gjykatave.

86.	Koncepti i “ngritjes në detyrë” i gjyqtarit të përfshijë promovimin dhe emërimin në detyra të reja gjyqësore. Ngritja në detyrë të bazohet në kritere objektive të paracaktuara në ligj dhe organi kompetent për vlerësimin e tyre të jetë KLD. Asnjë gjyqtar apo funkaionar i sistemit të drejtësisë gjatë periudhës së diktaturës komuniste të mos ketë të drejtë të promovohet.
87.	KLD të ketë detyrimin me ligj për të prezantuar, publikuar dhe për t’i dhënë efekt kritereve objektive të ngritjes në detyrë për të siguruar se selektimi dhe karriera e gjyqtarëve bazohen në meritë, duke u bazuar tek kualifikimet, integriteti, aftësitë dhe efienca e tyre. Vjetërsia në detyrë nuk duhet të jetë parimi udhëheqës që përcakton promovimin. Përvoja e përshtatshme profesionale është e rëndësishme dhe një parakusht i lidhur me vitet e përvojës ndihmon për të mbështetur pavarësinë. Konsideratat politike për ngritjen në detyrë janë të papranueshme.
88.	<p>Lidhur me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, të përmbushen standardet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> i. Kodi Etik i Gjyqtarit të rishikohet. Ai të hartohet dhe të miratohet nga vetë gjyqtarët; ii. Duhet të ketë një listë ose përshkrim të llojeve të sjelljes/etikës gjyqësore, shkelja e të cilës është e papranueshme iii. Gjyqtari ka të drejtën për jetën private, por ai duhet të veprojë me shkallën më të lartë të integritetit në jetën private dhe personale. Sjellja e cila shkakton diskreditimin e Gjyqësorit duhet të përbëjë bazë për procedimin disiplinor; iv. Ankesat të merren dhe të administrohen nga Inspektorati i KLD-së, që është i pavarur nga Ministria e Drejtësisë dhe që i përgjigjet vetëm Gjyqësorit. v. Një ankues normalisht duhet të identifikohet, megjithatë nëse një ankesë mund të bëhet nga kushdo, ka nevojë të ketë një mekanizëm ose një procedurë të shkurtër me të cilën ankesa mund të refuzohet ose me të cilën të merret një vendim se ankesa nuk duhet të vijojë më tej. Kjo procedurë duhet të jetë në kontroll të një gjyqtari ose një trupe gjyqtarësh ose një personi që i përgjigjet direkt Gjyqësorit. vi. Ankesa të hetohet nga Inspektorati i KLD-së, që është përgjegjës ndaj Gjyqësorit, i cili ka të drejtën të hetojë ankesën. Hetimi duhet të përfshijë mundësinë e marrjes së provave me shkrësë ose me gojë. vii. Inspektorati duhet të rregullohet me ligj. Ai të përfshijë në mazhorancë gjyqtarë, nga të gjitha nivelet dhe llojet e gjykatave. Organi përgjegjës për disiplinën gjyqësore të jetë një komision i KLD që përbëhet vetëm nga anëtarët gjyqtarë. viii. Duhet të ketë një afat kohor për paraqitjen e një ankese, që mund të zgjatet vetëm në rrethana përjashtimore. ix. Duhet të ketë një afat kohor për kryerjen e hetimit, për marrjen e një vendimi, si dhe për caktimin e një sanksioni. Caktimi i një sanksioni duhet të bëhet menjëherë pas vendimit mbi thelbin e çështjes dhe në çdo rast, pa vonesa të papërshtatshme. Këto afate duhet të jenë të tilla që mund të zgjaten vetëm në rrethana përjashtimore, siç janë kompleksiteti i hetimit, sëmundja e gjyqtarit ose një hetim penal.

	<p>x. Të mos publikohet emri i gjyqtarit përpara se t'i jetë caktuar sanksioni. Aty ku sanksioni i është caktuar, vendimi mund të publikohet (duke përmendur ose jo emrin e gjyqtarit në varësi të rrethanave të rastit).</p> <p>xi. Një gjyqtar duhet të pezullohet në rastet më të rënda dhe përjashtimore dhe nëse është e nevojshme për administrimin e drejtësisë.</p> <p>xii. Nëse një gjyqtar pezullohet, atij duhet t'i jepet 70 % e pagës së plotë gjatë hetimit, me përjashtim të rastit nëse gjyqtari shkakton vonesa domethënëse ose nuk bashkëpunon në hetim ose në rrethana të tjera përjashtimore. Çdo pagë që i është mbajtur atij gjatë hetimit duhet t'i ripaguhet gjyqtarit nëse ai nuk merr masë disiplinore ose nëse më vonë zbulohet që nuk i ka kryer veprimet e pretenduara.</p> <p>xiii. Një gjyqtar, nëse dëshiron, ka të drejtën të përfaqësohet ligjërish ose të asistohet nga një person që e zgjedh vetë. Një gjyqtar, akuzat ndaj të cilit rrëzohet, duhet të ketë mundësinë të rikuperojë kostot ligjore të arsyeshme që ka shpenzuar dhe aty ku është e përshtatshme edhe nga shteti.</p> <p>xiv. Gjyqtarit, subjekt i procedimit disiplinor, duhet t'i jepen të drejtat e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> të informohet plotësisht mbi çështjen kundër tij; të përfaqësohet; të kostove, në rast se akuzat ndaj tij bien, të paraqitjes në seancë dhe të dëgjimit, si dhe të kërkimit të provave me shkrim apo me gojë; të informohet menjëherë nëse një ankesë do të hetohet; t'i jepet një program aftesh për hetimin e ankesës dhe për marrjen e vendimit; t'i jepen arsyet për çdo vendim që merret; të apelojë <p>xv. Çdo sanksion duhet të jetë caktuar dhe autorizuar qartësisht nga ligji, proporcional në parim dhe në zbatim lidhur me çështjen konkrete.</p> <p>xvi. Duhet të ketë një të drejtë apeli në rrugë të rishikimit gjyqësor.</p>
89.	Të hiqet e drejta e Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të gjyqtarëve. Kjo kompetencë të mos jetë ekskluzive por të shpërndahet në autoritete të ndryshme.
90.	Të rishikohet imuniteti i gjyqtarëve nga procedimi disiplinor i gjyqtarëve në përbërje të Kolegjit Zgjedhor.
91.	Të rishikohet mosha e daljes në pension të gjyqtarëve, për ta përputhur me trendin e rritjes së jetëgjatësisë.
92.	Ndryshimet ligjore duhet të adresojnë çështjen e garantimit të statusit të gjyqtarit, ruajtjen e të gjithë të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga statusi i gjyqtarit, si dhe krijimin e incentivave për gjyqtarët që shërbejnë në struktura të tjera.
93.	Të përcaktohet shprehimisht në Kushtetutë përgjegjshmëria substanciale e gjyqtarit në ushtrimin e detyrës.
94.	Të përmirësohen detajet procedurale në dhënien e autorizimit për arrestimin e gjyqtarit.

95.	Të përmirësohet paga e gjyqtarit/prokurorit me rritje graduale, të shtrirë në 5 vjet, në masën 30 % çdo vit.
96.	Efiçenca të përmirësohet edhe nëpërmjet ndryshimit të legjislacionit procedural. K.Pr.C. duhet të parashikojë se nëse GJL kthen një çështje për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit dhe pas shqyrtimit nga kjo e fundit, çështja riparaqitet në GJL, ajo të mos ketë më të drejtë të vendosë kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit, por në këtë rast të bëjë vetë gjykimin përfundimtar të çështjes. Gjithashtu, duhet të marrë fund problematika në Gjykatën e Lartë që lidhen me zvarritjen e procesit për shkak të mosnjohimit të rregullt të palëve.
97.	Në adresimin e çështjeve të efiçencës në Gjykata, të ndiqen rekomandimet e projekteve të Këshillit të Evropës, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, i quajtur CEJ dhe të projektit “Drejtësia pa vonesa” i implementuar nga OSBE.
98.	Të rishikohen tarifat gjyqësore përmes një studimi të thelluar për të parë ndikimin tek ulja e ngarkesës në gjykata. Nëse do të vlerësohet rritja e tarifave gjyqësore, rrethanat financiare të palëve duhet të merren në konsideratë, përmes diferencimit të tarifave për këto shtresa ose përmes ndihmës juridike shtetërore për to.
99.	Të ndalohen me ligj për të apeluar në ligj çështje civile me vlerë të vogël financiare. Të krijohet një mekanizëm jo-automatik, duke i lënë diskrecion gjykatave për çështjet e komplikuar ligjore, të cilat kanë vlerë të vogël financiare. Rregullimi i akasesit në apel të bëhet nga vetë gjyqësori, duke konsideruar themelin e çështjes dhe jo nëpërmjet rregullave mekanike.
100.	Të zgjerohen zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve.
101.	Masat reformuese, duke përfshirë reduktimin e ngarkesës së çështjeve në gjykata dhe rritjen e tarifave gjyqësore duhet të sigurojnë aksesin në drejtësi, siç garanton neni 6 i KEDNj-së.
102.	Të thjeshtohen procedurat gjyqësore për të ulur numrin e llojeve të tyre. Të prezantohen procedura të thjeshta dhe të shpejta, që i lejojnë gjyqtarit kontroll të shtrënguar të seancës gjyqësore. Shkëmbimi i përsëritur i dokumenteve në gjykim dhe shtyrja e seancave të jenë përjashtim.
103.	Të merren masat për të eliminuar shtyrjen e arsytimit të vendimit, duke e konsideruar marrjen e vendimit pjesë të kohëzgjatjes së procesit gjyqësor dhe shpalljen e vendimit gjithnjë me arsyetim.
104.	Të merren masa të mëtejshme për të evituar taktikat vonuese të avokatëve dhe të palëve, siç është ndëshkimi financiar i avokatëve.
105.	Të dixhitalizohen procedurat gjyqësore përmes paraqitjes elektronike të çështjeve, shkëmbimit dixhital të dokumenteve me nënshkrime dixhitale. Të krijohet sistemi “e-court”, duke pilotuar fillimisht çështjet me vlerë të vogël.
106.	Të mirëmbahet dhe monitorohet sistemi audiorecording në gjykata, si dhe të prezantohen videoregjistrimet dhe videokonferencat, sidomos për të evituar lëvizjet e palëve apo të pjesëmarrësve në distanca gjeografike. Të parashikohen në legjislacionin procedural kriteret dhe procedura strikte të përdorimit të teknologjive të informacionit.
107.	Të studiohet dhe të synohet për krijimin e një sistemi elektronik të integruar të të dhënave të të gjitha shërbimeve, që lidhen me drejtësinë.
108.	Të përfshihet koncepti i menaxhimit strikt të çështjeve nga gjyqtari, si mjet që rrit efiçencën, duke parashikuar trajnimin e gjyqtarëve dhe hartimin e metodologjive specifike për gjyqtarët.
109.	Të rishpërndahen detyrat në gjykatë, me qëllim që gjyqtarët të fokusohen tek

	thelbi i detyrave të tyre gjyqësore. Për këtë qëllim të rriten kërkesat për profesionalizimin e stafit mbështetës në gjykata.
110.	Të merren masat për optimizimin e çështjeve tek gjykatat dhe gjyqtarët, duke parë mundësinë e prezantimit të mekanizmave fleksibël për caktimin e çështjeve në gjykata të ndryshme me qëllim barazimin e ngarkesës së tyre. Meqë kjo ka si pasojë udhëtimin e palëve, atëherë zgjidhja mund t'i lihet palëve: pala ose pranon të udhëtojë më shumë në një gjykatë më të largët ose pranon që çështja e tij të caktohet më vonë në kohë tek gjykata që ai ka më pranë. Një zgjidhje alternative është delegimi i përkohshëm i gjyqtarëve të gjykatave me pak ngarkesë tek gjykatat me shumë ngarkesë.
111.	Të vendoset si detyrë për stafin administrativ në gjykata për të mbledhur dhe analizuar të dhënat periodikisht, me qëllim dhënien gjyqtarëve të informacionit më thelbësor për kohëzgjatjen e çështjeve dhe çështjet e prapambetura.
112.	Të fuqizohet stafi IT në gjykata.
113.	Të studiohet mundësia e specializimit të gjyqtarëve brenda gjykatave në përputhje edhe me masat për riorganizimin gjyqësor.
114.	Të krijohen grupe konsultuese për gjykatat, që përfshijnë stafin e gjykatës dhe përdorues të saj, të cilët të takohen periodikisht.
115.	Të hartohen standarde të përgjithshme nga KLD për kohën e gjykimit të çështjeve, me qëllim që gjykatat të vendosin objektiva të përgjithshme për arritjen e standardeve si gjykatë, madje edhe palët ta dinë se çfarë presin dhe priren të bashkëpunojnë. Standardet të hartohen nga një analizë e kujdesshme e procedurave, si dhe e performancës konkrete të gjykatave në drejtim të shpejtësisë.
116.	Të thjeshtohen procedurat në Gjykatën e Apelit, të cilat duhet të fokusohen vetëm tek çështjet që kanë thelbin brenda, të përdoren flitrat e duhur për pranimin e çështjeve në apel dhe shkaqe për apel të jenë vetëm çështjet e spikatura. Procedura e zakonshme në Gjykatën e Apelit të jetë ajo e gjykimit mbi dokumente dhe të shtohet përdorimi i teknologjive të informacionit.
117.	Të forcohet ndërmjetësimi dhe të studiohet impakti i tij.
118.	Të rritet ndërgjegjësimi i publikut dhe ndihma juridike për ndërmjetësimin.
119.	Ndërmjetësimi të mbetet në thelb një proces vullnetar, gjyqtarët të pajisen me mjete procedurale urdhëruese ndaj palëve për të nxitur përdorimin e tij.

III. DREJTËSIA PENALE

120.	Kushtet dhe kriteret e emërimit të PP të jenë të ngjashme me ato që përdoren në rastin e gjyqtarëve të GjK, duke vënë theksin te përvoja profesionale, e ku si kriteret përparësie të jenë njohuritë në të drejtën penale si dhe aftësitë menaxheriale.
121.	Procedura e emërimit të realizohet nëpërmjet procesit ndërveprues të Presidentit të Republikës dhe Kuvendit.
122.	Procedura e zgjedhjes së PP, duhet të parashikojë një njoftim publik për të ftuar aplikantët të depozitojnë aplikimin e tyre. Njëkohësisht të publikohen edhe kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes, modalitetet e konkurrimit dhe burimin e informacionit prej nga do të grumbullohet informacioni për të vlerësuar përmbushjen ose jo të kriteretereve.
123.	Aplikimet duhet të bëhen në formë të shkruar së bashku me dokumentacionin që

	provon përmbushjen e kritereve.
124.	Presidenti i Republikës, në bazë të eksperiencës së kandidaturave dhe dokumentacionit shoqërues, përzgjedh tre kandidatë, dhe nëse ka femra në garë të paktën një prej tyre të jetë femër.
125.	Presidenti i përcjell Kuvendit 3 kandidaturat, për dhënien e pëlqimit për PP. Konsiderohet se ka marrë pëlqimin kandidati/ja që ka marrë numrin e votave sipas nje formule te sugjeruar edhe nga Komisioni i Venecias qe garantojne pamundesine e ndikimit poltik te mazhorances, te eliminoje kapjen politike ose sipas një procedure që garanton pjesëmarrjen substanciale të opozitës. Kjo procedurë duhet të përmbajë edhe një mekanizëm zhblllokues por duke garantuar eliminimin e kapjes politike nepermjet arritjes se nje numri te caktuar votash.
126.	Me propozim të Presidentit të Republikës, Parlamenti, me një vendim qe qe ka marre votat qe kane te njejtat garanci si ajo e emerimit, mund, të lirojë Prokurorin e Përgjithshëm nga detyra nëse Prokurori i Përgjithshëm është në pamundësi të përmbushjes së detyrave që rrjedhin nga mandati i tij/saj për arsye që nuk varen prej tij ose për shkak të dhënies së një vendimi përfundimtar gjyqësor që urdhëron masë mjekësore të detyrueshme në një proces penal. Presidenti merr paraprakisht mendimin e Keshillit të Prokurorisë.
127.	Me propozim të Presidentit të Republikës, Parlamendi shpall shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm me një vendim me numer votash sipas formulave te mesiperme, nëse Prokurori i Përgjithshëm dështon të përmbushë detyrat e tij/saj që rrjedhin nga mandati i tij/saj për arsye që varen prej tij ose për shkak të dhënies së një vendimi përfundimtar gjyqësor fajësie për shkak të kryerjes së një krimi. Presidenti merr paraprakisht mendimin e Këshillit të Prokurorisë.
128.	Vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e mësipërme të lirimit ose shkarkimit deklaron përfundimin e mandatit të PP.
129.	Prokurori i Përgjithshëm duhet të emërohet përfundimisht ose për një periudhë relativisht të gjatë pa mundësi riemërimi në fund të kësaj periudhe. Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm nuk duhet të përkojë me mandatin e Parlamentit. Mandati aktual i përmbush këto kritere, megjithatë në alternativë mund të shihet zgjatja e tij.
130.	Të saktësohet më tej në ligj punësimi i mëtejshëm të Prokurorit të Përgjithshëm pas përfundimit të mandatit, pasi kjo garanci duhet të bëhet e qartë përpara emërimit të tij. Nga ana tjetër, nuk duhet të ketë një ndalim të përgjithshëm për mundësitë e Prokurorit të Përgjithshëm për të aplikuar për detyra të tjera publike gjatë ose pas mbarimit të mandatit;
131.	Prokuroria të organizohet si një organ i pavarur, hierarkik, i centralizuar dhe me kompetencë ekskluzive të ushtrimit të ndjekjes penale. Brenda sistemit të prokurorisë mund të krijohen me ligj, trupa prokurorësh të specializuar për hetimin e tipologjive të përcaktuar të kriminalitetit nëpërmjet procedurave hetimore të posacme.
132.	Me qëllim ruajtjen e pavarësisë, parimit të centralizimit dhe parimit të ushtrimit të ndjekjes penale vetëm prej sistemit të prokurorisë, të parashikohet vetëm me ligj të veçantë, krijimi i një strukture të specializuar dhe të posaçme antikorrupsion.
133.	Çështjes së pavarësisë së prokurorisë ti jepet një rëndësi domethënëse. Megjithëse parimi i pavarësisë së prokurorisë, në vetvete, nuk është garanci e

	plotë e një modeli demokratik të ndjekjes penale. Për këtë arsye masa e pavarësisë duhet të jetë e tillë që të mos krijojë një sistem jashtë kontrollit.
134.	Parimi i pavarësisë apo autonomisë në organizimin e prokurorisë ka ndryshim nga ai që zbatohet për gjyqtarët. Prokuroria duhet të organizohet si organ i pavarur, ndërsa veprimtaria e prokurorit duhet t'i nënshtrohet kontrollit të brendshëm hierarkik.
135.	Hartimi i politikave të ndjekjes penale është një çështje ku legjislativi dhe Qeveria mund të kenë një rol vendimtar. Si një instrument për llogaridhënien e Prokurorit të Përgjithshëm mund të kërkohet paraqitja e një raporti publik para Parlamentit. Kur është e zbatueshme, në këto lloj raportesh, Prokurori i Përgjithshëm duhet të japë llogari transparente se si çdo udhëzim i përgjithshëm i dhënë nga ekzekutivi është zbatuar;
136.	Llogaridhënia e Prokurorit të Përgjithshëm ndaj Parlamentit për çështje individuale të ushtrimit ose mos-ushtrimit të ndjekjes penale nuk duhet të lejohen. Vendimi për të ushtruar ose jo ndjekjen penale duhet t'i përkasë vetëm organit të prokurorisë dhe jo ekzekutivit apo legjislativit;
137.	Sistemi i prokurorisë duhet të organizohet së brendshmi si një sistem me pavarësi relative, duke u strukturuar në korrespondencë me sistemin e gjykatave. I takon prokurorit më të lartë të kontrollojë prokurorët e nivelit menjëherë poshtë tij. Megjithëkëtë PP nuk duhet të kontrollojë drejtëpërdrejt prokurorin e nivelit më të fundmë. Në këtë mënyrë, sistemi i prokurorisë do të mbrohet nga ndërhyrjet politike apo influencat e tjera.
138.	Duhet të garantohet se udhëzimet e përgjithshme dhe direktivat mbi politikën penale të dhëna prej PP, duhet të publikohen, si dhe të përfshihen në raportin periodik që PP bën para Kuvendit.
139.	Prokurori si individ, përgjatë hetimit dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim është i pavarur. Në një sistem varësie hierarkik, prokurorët i nënshtrohen vetëm direktivave dhe udhëzimeve me përmbajtje të përgjithshme të lëshuara nga eprorët e tyre.
140.	E drejta për t'i dhënë udhëzime një prokurori më të ulët duhet të shtrihet vetëm tek udhëzimet me natyrë të përgjithshme dhe jo tek dhënia e udhëzimeve se si duhet të trajtohen çështje të vecanta. Një kufizim i tillë duhet të artikullohet qartësisht në ligj.
141.	Pavarësia e brendshme të konsistojë në një sistem ku prokurori individual në ushtrimin e veprimtarive të lejuara me ligj të mos ketë nevojë të marrë miratim paraprak dhe as konfirmim të mëpasshëm nga eprori i tij.
142.	Çështjet duhet t'u shpërndahen prokurorëve në bazë procedurash që garantojnë barazinë dhe paanshmërinë. Transferimi i çështjes nga një prokuror tek një tjetër i të njëjtit nivel mund të bëhet vetëm për shkaqe të pengesave ligjore për ushtrimin e ndjekjes penale.
143.	Me qëllim që të shmangen udhëzimet e parregullta, është thelbësore të zhvillohet një listë me garanci për mosndërhyrje në veprimtaritë e prokurorit. Mosndërhyrja të konsistojë në garancinë që veprimtaria e prokurorit në gjykim të jetë e çliruar nga presioni i jashtëm, si dhe nga presioni i brendshëm i paligjshëm apo i parregullt brenda sistemit të prokurorisë. Këto garanci duhet të mbulojnë emërimin, disiplinën/shkarkimin, por edhe rregulla specifike për menaxhimin e çështjeve dhe për procesin vendimmarrës.
144.	Të specifikohet saktësisht se çfarë kuptohet me "sistem hierarkik" të organizimit të prokurorisë. Të specifikohet saktësisht e drejta e udhëzimit që i jepet dikujt brenda sistemit, kujt saktësisht i jepet kjo e drejtë, cili është

	saktësisht rrethi i autoritetit të prokurorëve individualë, në cilat raste ata mund të marrin vendime me nismën e tyre, cilat vendime kërkohet të miratohen nga një prokuror më i lartë, cilat vendime mund të rishikohen dhe cilat jo, si dhe nga kush dhe për cilat shkaqe.
145.	Udhëzimet e përgjithshme të eprorit të drejtëpërdrejtë duhet të jepen gjithnjë me shkrim. Të njihet e drejta e prokurorit vartës të kërkojë sqarime dhe arsyetime shitesë ndaj prokurorit epror, të cilat gjithashtu duhet të jepen me shkrim.
146.	Prokurori më i ulët të ketë të drejtë që kur vlerëson se udhëzimet e eprorit të drejtëpërdrejtë bien në kundërshtim me ligjin, ose janë kundër bindjes së tij, të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes prej Këshillit të Prokurorisë. Kjo e drejtë të zbatohet në mënyrë koherente dhe dhe të arsyetuar. Alternativisht, kur prokurori më i ulët vlerëson se udhëzimet e eprorit të drejtëpërdrejtë bien në kundërshtim me ligjin, ose janë kundër bindjes së tij, ka të drejtë të japë dorëheqjen dhe në këtë rast, çështja hetohet konkretisht nga vetë prokurori epror që ka dhënë udhëzimin e vlerësuar të paligjshëm.
147.	Të parashikohet në nivel kushtetues se të gjithë prokurorët e të tria niveleve i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore, si dhe listimi në mënyrë të qartë dhe objektiv në ligj të të gjitha shkeljeve disiplinore dhe sanksioneve proporcionale me shkeljet
148.	Të parashikohet zhvillimit të procedimit disiplinor ndaj prokurorëve në dy shkallë gjykimi: para Këshillit të Prokurorisë (shkalla e parë) dhe para gjykatës administrative.
149.	Të parashikohent modalitetet ligjore të furnizimit të medias me informacionet e nevojshme, me qëllim informimin e publikut mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë. Autoriteti kompetent duhet të marrë masat të përcjellë një informacion të tillë, duke qenë shumë i kujdesshëm mbi prezumimin e pafajsisë së të akuzuarit, të drejtës për një gjykim të ndershëm dhe të drejtës për mbrojtje të jetës private dhe familjare të të gjithë personave të përfshirë në proces. Për këtë qëllim duhet miratuar kode sjelljeje ose udhërrëfyes lidhur me marrëdhëniet me mediat.
150.	Pushteti dhe përgjegjësia e prokurorëve të shtrihen vetëm të ndjekja penale e veprave penale dhe tek roli i përgjithshëm i mbrojtjes së interesit publik nëpërmjet sistemit gjyqësor penal.
151.	Të adoptohet modeli i ndjekjes së detyrueshme penale (legality principle). Përjashtimet e vetme mund të bëhen vetëm për arsye dhe në bazë kriteresh të mirëpërcaktuara në dobi të ndjekjes penale (dhënies së drejtësisë – rasti i dëshmitarëve të mbrojtur”)
152.	Sistemi ndjekjes penale të bazohet në sistemin akuzator. Administrimi i ndershëm i drejtësisë kërkon që të ketë barazi efektive armësh midis prokurorisë dhe mbrojtjes, si dhe respektim të pavarësisë së gjykatës, respektim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe forcë detyruese të vendimeve përfundimtare të gjykatës. Gjyqtarët dhe prokurorët duhet që secili të gëzojë pavarësinë në respekt të funksioneve të tyre, porse duhet të jenë dhe të duket se janë të pavarur nga njëri-tjetri.
153.	Sistemi i ndjekjes penale të bazohet në modelin që hetimet kontrollohen prej një autoriteti gjyqësor. Çdo atribum i funksioneve gjyqësore (të dhënies së drejtësisë) tek prokurorët mund të shtrihet vetëm për çështje që kanë të bëjnë me sanksionet e lehta të veprës penale (roli i prokurorit në akuzat private), dhe se në asnjë rast tjetër nuk duhet të ushtrohen njëkohësisht me autoritetin e ndjekjes penale në të njëjtën çështje, si dhe nuk duhet të kufizojë të drejtën e

	mbrojtjes për t'iu drejtuar gjykatës në këto raste.
154.	Ekskluziviteti i ndjekjes penale t'i përkasë vetëm sistemit të prokurorisë, me mundësinë që një pjesë veprash penale me natyrë të lehtë të ndiqen prej vetë individëve me akuzë private (kryesisht të dëmtuarit nga vepra penale)
155.	Sistemi i ndjekjes penale të ridimensionohet duke i njohur personave të dëmtuar nga vepra penale për të marrë pjesë në çdo fazë dhe shkallë të procedimit penal
156.	Të krijohen mekanizma ligjorë për të shmangur ndërhyrjen politike që synon vendimmarrjen e gabuar të prokurorisë, qoftë në rastin kur vendoset të ushtrohet ndjekja penale kur ajo nuk duhej filluar për shkak se nuk ka prova ose për shkak se është e bazuar në prova të falsifikuara apo të kompromentuara, qoftë në rastin kur vendoset të mos ushtrohet ndjekja penale e cila duhet të kishte filluar. Duhet të miratohen mekanizma që sigurojnë mënjanimin e presionit politik të papërshtatshëm në çështjet e ndjekjes penale. Ndjekja penale nuk duhet të përdoret në duart e mazhorancës si një mjet shtypjeje dhe si një mjet që ndihmon korrupsionin.
157.	Për të zgjidhur rastin e vendimeve të gabuara të prokurorisë për mosushttrimin e ndjekjes penale, duhet të zhvillohen mekanizma ligjorë proceduralë që sigurojnë kontrollin gjyqësor të këtyre rasteve me kërkesë të të dëmtuarve nga veprat penale
158.	Veprimet e prokurorit që prekin të drejtat e njeriut, si kontrolli apo arresti, duhet të mbeten nën kontrollin e gjyqtarëve;
159.	Të krijohen mekanizma mbrojtës që ndjekja penale të mos i nënshtrohet presionit të mazhorancës, që vjen për shkak të presionit nga manipulimit të opinionit publik prej mazhorancave, apo për shkak të presionit populist të saj, sidomos kur mbështetet nga fushatat mediatike, e për pasojë të përdoret prej saj si mjet shtypës.
160.	Këshilli i Prokurorisë të jetë një trup kolegjal i pavarur. Numri i anëtarëve të Këshillit të Prokurorisë, duhet të përcaktohet në funksion të gamës dhe volumit të funksioneve.
161.	Shumica substanciale e anëtarëve të Këshillit të Prokurorisë të zgjidhet nga kolegët e tyre. Anëtarët prokurorë të zgjedhur, duhet të përfaqësojnë të gjitha nivelet strukturore hierarkike të sistemit të prokurorisë dhe të mos jenë në pozita drejtuese administrative (drejtuesit e prokurorive të rretheve apo apelit) dhe të plotësojnë kriteret e treguara me sipër për gjyqtarët e GJL dhe GJK, për integritetin profesional, perfshihet dhe kriteret e përvosjes kur kanë qene në funksione dhe detyra gjate kohes se rregjimit komunist.
162.	Me qëllim që të sigurohet legjitimiteti demokratik i këtij Këshilli, anëtarët e tjerë të zgjidhen nga Parlamenti ndërmjet personave me kualifikimet e përshtatshme (profesorë të së drejtës dhe juristë të angazhuar në shoqërinë civile etj).
163.	Anëtarët e Këshillit të Prokurorisë, të emëruar nga Kuvendi, të zgjidhen nëpërmjet një shumice të cilësuar si në rastin e PP ose me pjesëmarrje substanciale të opozitës me qëllim për të garantuar paansinë dhe eliminuar kapjen politike.
164.	Një mekanizëm zhblllokues duhet të parashikohet për zgjedhjen e anëtarëve jo-prokurorë, psh zgjedhja nga Parlamenti duke përdorur një sistem proporcional, ose transferimi i të drejtës së zgjedhjes tek organizma të pavarur për të eliminuar kapjen politike janë të mirepritur.
165.	Anëtarët e Këshillit të Prokurorisë të qëndrojnë në detyrë për një afat prej 4 vjetësh. Anëtarët mund të rizgjidhen por duke siguruar që të paktën 4 vjet të

	kenë kaluar nga mandati i tyre i mëparshëm.
166.	Idealisht dy profesionet – gjyqtarët dhe prokurorët – duhet të përfaqësohen nga organe të ndara (KLD dhe Këshilli i Prokurorisë).
167.	Me qëllim garantimin e pavarësisë, zgjedhja e drejtuesit të Këshillit të bëhet nga anëtarët e tij nëpërmjet një mekanizmi zgjedhor.
168.	Mandati i këtyre anëtarëve duhet të përfundojë vetëm me skadimin e këtij afati, me daljen në pension, me dorëheqje ose vdekje, ose me shkarkimin e tyre për arsye disiplinore.
169.	Një procedurë disiplinore duhet të zbatohet në rastet e shkeljeve disiplinore.
170.	Rastet kur një anëtar i Këshillit të Prokurorisë mund të shkarkohet duhet të specifikohen në ligj.
171.	Asnjëherë nuk duhet të parashikohet si shkak shkarkimi “mungesa e besimit” prej organit që i ka zgjedhur këta anëtarë.
172.	Procedura disiplinore duhet të garantojë një gjykim të drejtë për anëtarin e Këshillit të Prokurorisë.
173.	Shkarkimi të vendoset vetëm nga anëtarët e tjerë të Këshillit, me një shumicë të cilësuar, pa pjesëmarrjen e anëtarit të interesuar.
174.	Përgjatë vlerësimit të marrjes së masës së shkarkimit (ose pezullimit), duhet mbajtur parasysh proporcionaliteti midis shkeljes dhe masës, si dhe të përcaktohet procedura e konstatimit objektiv të shkeljes
175.	Ankimi në gjykatë ndaj masave të shkarkimit (pezullimit) të anëtarëve të Këshillit duhet të parashikohet shprehimisht.
176.	Asnjë anëtar i Këshillit të Prokurorisë, i zgjedhur nga prokurorët, nuk duhet të ketë të drejtë, përgjatë shërbimit në Këshill, të promovohet brenda shërbimit.
177.	Anëtarësia në Këshill mund të pezullohet atëherë kur statusi si prokuror pezullohet, për shembull për shkak të një hetimi penal në proces ose për arsye të tjera sipas ligjit psh në rastin e një procedure disiplinore për aq kohë sa vazhdon kjo procedurë.
178.	Paafësia fizike e anëtarit të Këshillit të Prokurorisë të përmbushë funksionet duhet në fakt të shkaktojë shkarkimin, edhe nëse kjo është shkaktuar nga arsye objektive. Megjithatë, periudha e kohës në të cilën ai ka munguar duhet të merret në konsideratë: një periudhë kohe minimale duhet qartësisht të vendoset, pas së cilës shkarkimi i anëtarit mund të kërkohet.
179.	Mbledhjet e Këshillit të Prokurorisë duhet të jenë të hapura për publikun, nëse Këshilli nuk vendos të punojë me mbledhje të mbyllur, përveç rasteve kur siguria arsye të tjera që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale mund të kërkojnë mbledhje të mbyllura dhe në përputhje me rregullat e tij të procedurës, si një rast përjashtimor.
180.	Një Komision tjetër të krijohet brenda Këshillit të Prokurorisë, me objektivin prioritar të veprimtarisë shqyrtimin e vlerësimit përfundimtar të performancës së prokurorëve. Në alternativë të kësaj zgjedhjeje vlerësimi i performancës në instancë të parë mund të bëhet nga një inspektorat i specializuar i caktuar nga PP, e më pas shyrtimi përfundimtar të bëhet nga Këshilli.
181.	Këshilli duhet të përfshihet në punën e përditshme operacionale. Për këtë arsye duhet të organizohet si një organ me kohë të plotë. Garancitë e statusit të anëtarëve prokurorë rregullohen <i>mutatis mutandis</i> si në rastin e gjyqtarëve anëtarë të KLD.
182.	Të njihet e drejta e ankimit tek gjykata administrative kundër vendimit të Këshillit të Prokurorisë. Kontrolli gjyqësor i vendimeve të Këshillit është një

	mase e mirepritur.
183.	Tendenca duhet të jetë që sa më shumë kompetenca rreth statusit dhe veprimtarisë së brendshme të adresohen te Këshilli i Prokurorisë me qëllim kufizimin e influencave politike të papërshtatshme mbi këto çështje, me qëllim garantimin e pavarësisë institucionale dhe pavarësisë individuale të prokurorëve.
184.	Këshilli i Prokurorisë si një nga institucionet brenda sistemit të Prokurorisë, ka fuqi vendimmarrëse, lidhur me çështjet e statusit të prokurorëve, emërimit dhe promovimit të tyre, procedimit disiplinor dhe mbarëvajtjes së veprimtarisë së brendshme të sistemit të prokurorisë.
185.	Kriteret e emërimit të prokurorëve dhe emërimi i tyre në nivelet e larta administrative të sistemit të prokurorisë, bazohet në kritere të cilat aplikohen <i>mutatis mutandis</i> si edhe për gjyqtarët.
186.	Parashikime të përgjithshme si psh shtetësia, gjendje e mirë shëndetësore, kompetenca profesionale, mungesa e çdo procedimi penal aktual dhe në të shkuarën janë kërkesa që duhet të trajtohen në mes të kushteve dhe kritereve përzgjedhëse. Promovimi duhet të bazohet thelbësisht në vlerësimin e performancës. Asnjë prokuror apo funksionar i sistemit të drejtësisë gjatë periudhës së diktaturës komuniste të mos ketë të drejtë të promovohet.
187.	Aksesi në sistemin e prokurorisë, të bëhet ekskluzivisht duke parashikuar si kusht diplomimin profesional nëpërmjet trajnimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pa lejuar asnjë përjashtim nga ky rregull.
188.	Në çdo rast, e drejta e PP, që të marrë vendime thelbësore sidomos për emërimin, procesin disiplinor, promovimin, vlerësimin nuk duhet të humbasë nga kompetenca vendimmarrëse e Këshillit të prokurorisë.
189.	Propozimi për emërimin e prokurorëve më të ulët, qoftë në rastin e hyrjes në sistemin e prokurorisë, qoftë në rastet e emërimit në nivelet hierarkike administrative të prokurorisë duhet të bëhet prej PP. Këshilli i Prokurorisë të ketë të drejtën vetëm të refuzimit të emërimit, porse vetëm bazuar në arsye të shëndosha.
190.	Parimi i palëvizshmërisë aplikohet për gjyqtarët dhe jo për prokurorët. Megjithëkëtë, prokurorët duhet të kenë mundësinë të ankimojnë kundër transferimeve të detyrueshme.
191.	Çështja e komandimit të detyruar duhet të aplikohet vetëm kur dhe për aq sa zgjat nevoja për të kapërcyer problemet funksionale nëpërmjet vendosjes së burimeve njerëzore në mënyrë efektive, në mënyrë që të sigurohet përmbushja e detyrave të kërkuara. Komandimi i detyruar nuk duhet përdorur si mjet që mund të rrezikojë pavarësinë e prokurorit.
192.	Garancitë procedurale për çdo prokuror që mund të transferohet me detyrim, të parashikohen në ligj dhe kriteret për një transferim të tillë të parashikohen qartë dhe së bashku me mundësinë e prokurorit që ka pësuar një të tillë, të ketë të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj vendimit përkatës,
193.	Rreziku potencial i komandimit kundër vullnetit të prokurorit, duhet të balancohet nëpërmjet garancive. Një e drejtë e plotë ankimi pa efekte pezullimi ndaj komandimit duhet parashikuar. Prokurori i cili është komanduar mund të paraqesë një kundërshtim në Këshillin e Prokurorisë, i cili duhet së paku të mundësojë një shqyrtim <i>ex post</i> të rastit. Ky shqyrtim duhet të trajtojë edhe aplikimin e drejtë të kritereve ligjore.
194.	Prokurorët duhet të qëndrojnë në detyrë pa kufizim deri në moshën e pensionit. Ndërprerja e qëndrimit në detyrë mund të bëhet vetëm për shkaqe të shkarkimit

	si pasojë e procedimit disiplinor ose lirimit për shkaqe subjektive.
195.	Është e nevojshme të parashikohet një procedurë objektivist transparente në procesin e promovimit të prokurorëve. Ky proces nuk mund t'i lihet vetëm diskrecionit të eprorit të drejtëpërdrejtë.
196.	Procesi i vlerësimit bëhet shumë më i pavarur nëse bëhet prej Këshillit të Prokurorisë. Minimalisht vendimi përfundimtar mbi vlerësimin t'i besohet Këshillit. Përfshirja e disa anëtarëve "të jashtëm", në nënkomisionin e Këshillit që trajton vlerësimin (nëse kjo nuk i besohet Këshillit në formacion të plotë) do të ndihmonte garancitë e pavarësisë dhe paanësisë.
197.	Mundësia e një ankimi kundër vendimeve kundër vlerësimit të gabuar ose të pavërtetë të komisionit të vlerësimit, duhet të parashikohet qartësisht.
198.	Nevoja për parashikime që pranojnë ankimin në gjykatë nuk duhet të kufizohet vetëm tek sanksionet disiplinore, por duhet të përfshijë edhe akte që kanë efekte negative në statusin ose veprimtarinë e prokurorëve, psh: mohimi i një promovimi, depozitimi i komenteve negative në dosjen personale të promovimit, ndryshimi i rrethit të ushtrimit të detyrës etj. Në një vend ku aplikohet shteti i së drejtës është e nevojshme për parashikime të mjeteve mbrojtëse nëpërmjet gjykatës në këto raste.
199.	Vlerësimi si "i paafte" duhet të parashikohet si bazë objektive për nismën disiplinore. Ky është një faktor, i cili duhet të rregullohet me saktësi të madhe për të parandaluar shndërrimin e tij në një mjet të papërshtatshëm ndërhyrjeje në paanësinë. Për këtë shkak, sistemi i vlerësimit të performancës duhet të parashikohet në ligj. Autoriteti kompetent që realizon vlerësimin duhet të specifikohet, se bashku me rrethanat, në bazë të të cilave këto shkaqe mund të të aplikohen.
200.	Një sistem i tillë duhet të parashikojë kritere objektive për vlerësimin dhe të përfshijë domosdoshmërisht garancinë për ankim ndaj vlerësimeve negative.
201.	Në rastin e prokurorëve, të ndryshëm nga PP, vendimet mbi shkarkimin duhet të merren nga Këshilli i Prokurorisë.
202.	E drejta për një seancë dëgjimore të drejtë dhe aksesin në një gjykatë të pavarur, e cila do të mbikëqyrë procesin, nuk duhet të cenohen dhe duhet të parashikohen shprehimisht në ligj.
203.	Masat disiplinore nuk duhet të vendosen prej eprorit të drejtëpërdrejtë, i cili është njëkohësisht edhe akuzues edhe gjykes, si në një sistem inkuizitorial. I takon PP të promovojë nismën e procedimit disiplinor, në bazë të procedurës, që i heq atij mundësitë e bllokimit ndaj çdo ankese, si dhe të njihet edhe mjeti i Inspektoratit Disiplinor.
204.	Në procedimet kundër prokurorëve, Këshilli duhet të vendosë nëpërmjet një komisioni i konstituuar vetëm me prokurorë.
205.	Inspektorati për inspektimin disiplinor (prokurori disiplinor) të prokurorëve të parashikohet në ligj dhe të zgjidhet prej Këshillit të Prokurorisë, duke parashikuar kriteret që kërkohen për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Prokurorisë për anëtarët jo prokurorë. Kjo do të rriste autonominë dhe pavarësinë e hetimeve disiplinore, të cilat janë të një rëndësie të veçantë, qoftë për prokurorin, qoftë për publikun.
206.	Në çështjet disiplinore, që përfshijnë sigurisht edhe shkarkimin e prokurorëve, prokurori i përfshirë duhet të ketë të drejtën të dëgjohet në një procedim kontradiktor.
207.	Prokurori, subjekt i sanksionit disiplinor, duhet të ketë të drejtën të ankohet në gjykatën administrative, e cila duhet të ketë të drejtën e ridëgjimit të çështjes

	(gjkimit në themel) dhe jo vetëm thjesht shqyrtimin e procedurës.
208.	Të saktësohet se prokuroria është autoriteti i vetëm që drejton veprimtarinë hetimore me vlerë probatore (mbledhëse e provave).
209.	Prokuroria të kontrollojë dhe vleftësojë veprimet hetimore paraprake të policisë, që i kryen me iniciativë përgjatë veprimtarisë së saj të parandalimit të sjelljeve kriminale, sidomos ato që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë themelore të individit.
210.	Policia gjyqësore të jetë në varësi operationale të prokurorisë dhe të kryejë vetëm veprimet hetimore të deleguara prej saj. Prokuroria të saktësojë instruksione të detajuara që duhen përmbushur nga policia, me qëllim të realizimit efektiv të prioriteteve hetimore, pra mjetet që duhet të përdorë për kërkimin e provës, stafin që duhet të përdorë, kohëvazhdimin e veprimeve hetimore, informacioni që duhet t’iu përcjellë prokurorit etj.
211.	Prokuroria të ketë të drejtë të përcaktojë ajo, caktimin e korpuseve të policisë që duhet të kryejnë hetimet për një çështje apo një seri të caktuar veprimesh hetimore.
212.	Prokuroria të ketë të drejtë të bëjë vlerësim performance si dhe inspektime ndaj policisë gjyqësore, për shkak të nevojës që ka për të monitoruar se veprimet hetimore po përmbushen në përputhje me ligjin. Prokuroria të ketë të drejta mbi statusin e nëpunësve të policisë dhe specifikisht të iniciojë procedura disiplinore nëse konstatohen shkelje ligjore administrative.
213.	Statusi i punonjësve të policisë të monitorohet njëkohësisht edhe prej prokurorisë, lidhur me veprimtarinë e policisë brenda dhe për aq sa i përket angazhimit të saj në veprimtarinë hetimore nën urdhërimin dhe kontrollin e prokurorisë.
214.	Ndryshimet në KPP, të përgatitura nga Ministria e Drejtësisë, e asistuar nga ekspertë ndërkombëtar të OPDAT, EURALIUS III, OSBE, Këshilli i Europës, Projekti JUST i USAID, etj., t’i përcillen menjëherë Komisionit të Posacëm Parlamentar për të vijuar më tej me procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të tyre.
215.	Kodi Penal ka nevojë për përmirësime dhe cdo masë që synon përmirësimin dhe harmonizimin e përmbajtjes së tij është e mirëpritur. Në këtë drejtim, mbështesim idenë për të vlerësuar mundësinë e hartimit të një Kodi të ri Penal.
216.	Mbështesim plotësisht mundësinë e krijimit të burgjeve private, si dhe shtrirjen e mbikëqyrjes elektronike në të gjithë Shqipërinë.

IV. EDUKIMI LIGJOR DHE ARSIMI JURIDIK

217.	Të specifikohet detyrimi i përfshirjes në kurrikulat e arsimit parauniversitar të lendeve të edukimit ligjor si disiplina të mevetshme në të gjitha ciklet parauniversitare si lende të detyrueshme apo me zgjedhje. Për këto masa kërkohet nderhyrje konkrete në VKM-te për kurrikulat parauniversitare. Këto lende të përzgjidhen prej vete shkollave ndërmjet alternativave të teksteve të hartuara nga juristet vendas, për shkak se sistemi ligjor i cdo vendi është specifik dhe për këto arsye nuk të lejon të adoptohen tekste shkollore të huaja.
218.	Do të ishte me efikase që masat për arsimin e lartë juridik të përcaktohen duke pasur parasysh mënyrën e re të organizimit dhe të funksionimit të arsimit të lartë

	juridik dhe problematikat qe mund te shfaqen mbas hyrjes ne fuqi te ligjit te ri te Arsimit te larte.
219.	Vendosia e nje raporti fiks ligjor midis numrit te studenteve te nje Fakulteti Juridik dhe pedagoqeve te atij fakulteti.
220.	Parashikimi i mundësisë ligjore për nje bashkëpunim midis Fakultetit të Drejtësisë me Kuvendin e Republikës dhe Ministrinë e Drejtësisë per perdorimin e ekspertizes akademike ne te gjitha ndryshimet ligjore apo reformat ligjore, do te ndihmonte shume jo vetem kerkimin shkecor, por dhe nivelin e ligjeve qe hartohen ne vend.
221.	Ndërmarrja e iniciativave ligjore per permiresimin e trajtimit financiar te punonjesve mesimore shkencore ne Fakultetet Juridike.
222.	Detyrimin e Fakulteteve Juridike qe nje pjese te leksioneve te zhvillohen nga personalitetet me ekspertizen me te vecante ne fushen juridike, ne formen e ftesave per pedagoget e jashtem qe do te duhet te jene personalitete vendase apo te huaja ne nje fushe te caktuar te kerkimit shkencor, apo ne nje tematike te caktuar te nje disipline ne lendet juridike.
223.	Formimi vazhdues i njohurive të profesionistëve të lirë te zhvillohet periodikisht nga dhomat kombetare te profesioneve te lira, të cilat mund te organizojne trajnime apo kurse vazhduese per ti mbajtur koherent me ndryshimet ligjore.
224.	Cdo menyre apo mekanizëm per tu bere pjese e sistemit gjyqësor qe shmang Shkollen e Magjistratures, kontrollin e aftesise nepermjet konkurrimit per tu pranuar ne te, është I PAPRANUESHËM për ne.
225.	Per nje formim me te plote, per nje vleresim me profesional dhe per nje proces jashte cdo ndikimi në Shkollën e Magjistratës vlerësohet e nevojshme edhe ndryshimi i menyres së organizimit administrativ dhe akademik te procesit mesimor, kriteret e perzgjedhjes se stafit akademik dhe vleresimit te studenteve te Shkolles se Magjistratures.
226.	Garantimi i pavarsise se Shkolles se Magjistratures, dhe nxjerrjes se tij jashte ndikimit te pushtetit ekzekutiv, duke e përfshirë brenda ombrellës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në këtë drejtim, është e nevojshme që të zhbëhen ndërhyrjet e fundit që i janë bërë ligjit për Shkollën e Magjistratures.
227.	Është e PAPRANUSHME për ne masa që parashikon mundësinë e vendosjes së kuotave proporcionale për pranimin jashtë konkursit në Shkollën e Magjistraturës në përputhje me nevojat që dikton sistemi dhe në çdo rast parashikimin e ndjekjes së detyrueshme të Shkollës të paktën një vit! Per ne kjo mase eshte krejt e papranueshme dhe në shkelje flagrante të standardeve ndërkombëtare për pranimet në gjyqësor. Parashikimi i një mase të tillë e rikthen sistemin në gjendjen që ishte përpara viteve 2000.
228.	Janë të nevojshme nderhyrje ne ligjin e Shkolles se Magjistratures per sigurimin e nje stafi jo vetem profesional, por edhe jashte ndikimit politik.
229.	Duke pasur parasysh rendesine e vleresimit te studenteve te shkolles se magjistratures sa i perket dhe gjykates apo prokurorise ku do te emerohen, do te ishte e nevojshme dhe percaktimi i nje sistemi vleresimi modern dhe objektiv, si e vetmja menyre per sigurimin e profesionalizmit dhe pavarsise se gjyqtareve apo prokuroreve te ardhshem.
230.	Mundësia që ofron ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor, për emërimin si gjyqtar deri në 10 % të personave jashtë Shkollës së Magjistraturës, duhet të hiqet në ligj. Ky parashikim ka qenë një këmbëngulje pa argumenta e Partisë Socialiste në kohën e miratimit të ligjit, por vlerësojmë se ka dëmtuar dhe vijon të dëmtojë profesionalizimin dhe pavarësinë e sistemit.

V. SHËRBIMET LIGJORE DHE PROFESIONET E LIRA

231.	Fuqizimi i mëtejshëm i Shkollës së Avokatisë është i nevojshëm, për shkak se është një organizëm i ri dhe në konsolidim e sipër.
232.	Parashikimi me ligj të një mekanizimi që fuqizon transparencën dhe objektivitetin e provimit të avokatisë, rritjen e numrit të trajnimeve për rregullat e etikës dhe rregullat ligjore për ushtrimin e profesionit të avokatisë.
233.	Detyrimi i sigurimit profesional të avokatëve është aktualisht në ligj, por ka dështuar të aplikohet në praktikë. Për pasojë, është e nevojshme që të identifikohen rrugët për zgjidhjen ligjore të problemit.
234.	Për eliminimin e evazionit fiskal është e nevojshme që vetë Dhoma Kombëtare e Avokatisë të përcaktonte tarifa standarde minimale shërbimi dhe detyrimin e avokatëve për të lëshuar faturë për cdo shërbim të ofruar, të kundërfimosur edhe nga përfituesi i shërbimit.
235.	Zgjidhje të problematikës së shtyrjes së proceseve gjyqësore për shkak të mungesës së avokatëve. Kjo do të kërkonte ndryshime përkatëse në Kodet e procedurave, ku të parashikohej mundësia që gjyqtarët për zvarritje të qëllimshme të procesit nga ana e avokatëve të kishin mundësi për gjatësimin e tyre, krahas kërkesës për marrjen e masave disiplinore ndaj avokatit.
236.	Rishikimi i pagesave shumë të ulta për avokatët kryesisht. Kjo do të kërkonte parashikimin e mundësisë që këto avokatë të paguhen sipas tarifave të tregut, të paracaktuara nga vetë Dhoma Kombëtare e Avokatisë (tarifa standarde minimale). Mendojmë se pagesa e këtyre avokatëve sipas tarifave të tregut do të ndihmonte edhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj klientëve, sepse praktika ka treguar që cilësia e përfaqësimit nga avokatët kryesisht është e ulët dhe çënon të drejtën e personit për një proces të rregullt ligjor.
237.	Forcimi i mekanizmave ligjore që garantojnë bashkëpunimin e avokatëve me institucionet shtetërore. Mbi këtë problematikë mendojmë se është e nevojshme që të ndryshohet dispozita përkatëse në ligjin për avokatinë, duke parashikuar një mekanizëm ndëshkimi disiplinor, deri në largim nga detyra, për zyrtarët që nuk japin informacionet/dokumentet e kërkuara nga avokatët dhe që bëhen premisë për çënimin e të drejtës së individit për një proces të rregullt ligjor.
238.	Është e domosdoshme që të rishikohen kriteret ligjore për t'u bërë noter. Ne vlerësojmë se një eksperiencë minimalisht 10 vjet në profesion si jurist është e nevojshme që të garantohet profesionalizimi i noterëve.
239.	Është e nevojshme që shërbimi "One Stop Shop për noterët" të shtrihet në të gjithë territorin e RSH. Gjithashtu, duhet vlerësuar mundësia e dixhitalizimit të mëtejshëm të veprimtarisë noteriale.
240.	Duhet vlerësuar mundësia që noterët të bëhen agentë tatimor, sepse në këtë mënyrë zgjidhet problematika e mospagimit të detyrimeve tatimore në rastin e realizimit të transaksioneve pranë noterit.
241.	Përmirësimi dhe zhvillimi i mëtejshëm të Regjistrimit Noterial Shqiptar (RNSH).
242.	Është e nevojshme që të përcaktohen në ligj kriteret e qarta se cila kategori personash përfiton falas shërbimet noteriale, duke qenë se jemi përpara një shërbimi privat me karakter tërësisht publik.
243.	Miratimi i ndryshimeve të nevojshme në ligj, me qëllim që të mundësohet sigurimi i noterëve në lidhje me përgjegjësinë civile ndaj të tretëve.

244.	Të forcohen rregullat për përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e përmbaruesit gjyqësor dhe aplikimin e sanksioneve të forta për mosekzekutimet në kohë pa shkaqe objektive.
245.	Përmbarimi gjyqësor shtetëror ka dështuar të përmbush misionin e vet. Për këtë shkak mendojmë se është e përshtatshme që i gjithë shërbimi përmbarimor të kalojë në shërbim përmbarimor privat. Kjo masë do të kërkonte domosdoshmërisht aplikimin e mekanizmave të nevojshëm për të lehtësuar ekzekutimin pa pagesë të vendimeve gjyqësore për personat në nevojë. Ligji duhet të parashikojë kritere të qarta për përjashtimin e tyre nga tarifat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Nga ana tjetër, privatizimi 100 % i këtij shërbimi duhet të shoqërohet me një mekanizëm të përforcuar kontrolli dhe llogaridhënie nga ana e strukturave shtetërore mbikëqyrëse.
246.	Të parashikohen masa efikase që garantojnë ekzekutimin e vendimeve, kur janë të përfshira institucionet shtetërore. Është e nevojshme që të rishikohen rregullat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ndaj institucioneve shtetërore dhe parashikimin e mundësisë për shkarkim nga detyra të cdo zyrtari publik që pengon me veprime apo mosveprime ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.
247.	Parashikimi në ligj i një mekanizmi të përshtatshëm që garanton përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e ndërmjetësit.
248.	Shkrirjen e Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe bashkimin e këtij institucioni me Policinë Shkencore, nën emërtesën Instituti i Ekspertimit Shkencor. Në vlerësimin tonë, rritja e bashkëpunimit midis Mjekësisë Ligjore dhe Policisë Shkencore dhe ushtrimi i veprimtarisë së tyre brenda të njëjtit institucion do të ndihmonte në rritjen e mundësisë për koordinimin e informacionit/rezultateve, duke dhënë një kontribut të cmuar në realizimin e hetimeve të sakta dhe të shpejta.
249.	Garantimi i mbështetjes së nevojshme financiare për mjeksinë ligjore, me qëllim sigurimin e mjeteve bashkëkohore të punës dhe përmirësimi i statusit të punonjësve të kësaj strukture.
250.	Forcimi i mekanizmave të kontrollit dhe llogaridhënies për përkthyesit zyrtar dhe ekspertët e fushave të ndryshme që përfshihen në procese gjyqësore. Aktualisht veprimtaria e tyre është e parregulluar plotësisht dhe nuk ekziston asnjë mekaizëm llogaridhënie për ushtrimin e veprimtarisë nga ana e tyre.
251.	Dixhitalizimin e shërbimeve në ZRPP, duke aplikuar sistemin “One Stop Shop” në të gjithë Shqipërinë.
252.	Gjetjen e mekanizmit të përshtatshëm ligjor për të detyruar QBZ të përmbush detyrimet e parashikuara nga ligji, vecanërisht përsa i përket arkivës elektronike të legjislacionit dhe përditësimin e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

VI. MASAT ANTIKORRUPSION

253.	Modeli ynë kushtetues është ai i sistemit të centralizuar (neni 149 i Kushtetutës) dhe si i tillë, nuk mundëson krijimin e “prokurorive paralele kushtetuese” apo “super prokurorive kushtetuese” (rasti i SPAK dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit), që nuk respektojnë ndarjen dhe balancimin e pushteteve nga njëra anë dhe pavarësinë dhe paanësisë si kushte bazë të pushtetit gjyqësor. Modeli ynë kushtetues mundëson që në nivel ligji, strukturimi i prokurorisë të përshtatet më fenomenologjinë kriminale nga njëra anë (prokuroritë e specializuara) dhe
------	--

	përshtatjen e procedurave hetimore-probatore (mbledhëse provash)-gjykimore.
254.	Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që e ka cilësuar ngritjen e Byrose Kombëtare të Hetimit si antikushtetues DUHET TË RESPEKTOHET PLOTËSISHT . Ndryshimi i Kushtetutës në favor të ligjit qeveritar të shpallur antikushtetues është i papranueshëm prej nesh. Cdo strukturë hetimore duhet të ngrihet duke respektuar vendimin përkatës të kësaj gjykate dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, që garanton parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe autoritetin e padiskutueshëm të Gjykatës Kushtetuese për garantimin e shtetit të së drejtës.
255.	Lidhur me SPAK, ideja e “prokurorive të specializuara” që targetojnë vetëm fenomenin e korrupsionit nuk është e re, madje në disa vende ka rezultuar e sukseshme. Porse modelimi, ashtu siç sugjerohet, në Kushtetutë, pra miratimi në Kushtetutë i një organi <i>extra</i> , paralel me sistemin e prokurorisë, vendos në krizë pikërisht sistemin kushtetues të organizimit të prokurorisë si një organ i centralizuar. Janë të gjitha mundësitë, që një prokurori e specializuar të krijohet dhe se Kushtetuta siç është e pranon një mundësi të tillë (rasti i prokurorisë për krimet e rënda), e cila të fokusohet vetëm në fenomenologjinë korruptive, porse në respektim të modelit organizativ aktual që ka bërë Kushtetuta. Prokuroritë e specializuara, nuk e gjejnë suksesin e tyre, duke dalë si organe totalisht jashtë kontrollit, pasi një eksperiment i tillë do të kthehej lehtësisht në mjet presioni politik (si dikur me sistemin komunist). Propozimi ynë është që të parashikohet në legjislacion dhe të implementohet një model SPAK-u, të cilët veprojnë nën ombrellën e organit të prokurorisë.
256.	Forcimi i llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve është një masë e mirëpritur. Krijimi i institucioneve të reja duhet të mbajë parasysh riskun e lartë të përfitimit politik të mazhorancës aktuale nisur nga shumica që disponon në Kuvend. Ngritja e institucioneve të reja mbart riskun e fragmentarizimit të tepruar institucional dhe eventualisht edhe mungesën e bashkëpunimit të shëndoshë në arritjen e rezultateve të kërkuara. Vetëm një model evropian i cili duhet të garantojë 100 % shmangien e ndikimit politik të kontrollit të gjyqtarëve e prokurorëve mund të ishte një çështje që do mund të diskutohet gjerësisht në tryezat konsultative. Ne mbështesim rekomandimin e GRECO për një vetërregullim dhe vetëkontroll të gjyqësorit, dhe jo një kontroll të jashtëm të tij nga mazhoranca nëpërmjet militantëve të maskuar si apolitik. Sjellja e mazhorancës aktuale në këto 2 vite, nuk jep garanci për krijimin e institucioneve paralele të pavarura.
257.	Bashkëpunimi i publikut në luftën kundër korrupsionit, duhet të shmangë aplikimin e metodave të vjetra, që të rikthejnë në mendje periudhën e errët komuniste.
258.	Vlerësimi periodik i performancës profesionale dhe etike të gjyqtarit/prokurorit të bëhet në kohën e duhur dhe të merret në konsideratë duke u siguruar që kriteret e vlerësimit të etikës së gjyqtarëve të jenë objektive dhe transparente, duke pasur në vëmendje parimin e pavarësisë së gjyqësorit.
259.	Ne mirëpresim tërësisht një vlerësim konkret, eficient dhe të shpejtë të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në kontrollin e punës së tyre, efikasitetin, llogaridhënies, shpejtësisë, respektimit të ligjit dhe Kushtetutës. NUK MBËSHTESIM asnjë testim qeveritar, testim njohurish profesionale, nëpërmjet provimeve, testeve të njohurive apo testeve psikologjike. Procese të tilla nuk mbështeten nga ana jonë, sepse një procedurë e tillë minon thellësisht çështjen e statusit të tyre (palëvizshmëria nga detyra) dhe njëkohësisht hap dritare për

	politizim ekstrem të vetë pushtetit gjyqësor.
260.	Komiteti i Verifikimit të Mandateve dhe Zhvillimit të Vazhduar Profesional' në Konferencën Gjyqësore Kombëtare të permblusë mandatin e tij dhe të sigurojë në mënyrë pro-aktive ekzekutimin e rregullave të etikës; si dhe që udhëzime, konsultime dhe shërbim i detyrueshëm i trajnimit ti ofrohet gjyqtarëve mbi etikën, konfliktin e interesit dhe parandalimin e masave antikorrupsion brenda rradhëve të tyre.
261.	Nuk është e pranueshme krijimi i i strukturave paralele apo institucioneve paralele, por rekomandojmë forcimin e pavarësisë së ILKDP dhe rritjen e kapaciteteve të pavarura për një hetim të shpejtë dhe efikas. Propozimi ynë është fuqizimi dhe depolitizimi i ILDKP, duke parashikuar atë si organ kushtetues, me kompetenca dhe status kushtetues dhe ku Inspektori i Përgjithshëm të zgjidhet me propozim të Presidentit të Republikës, dhe me miratimin e 2/3 të anëtarëve të Kuvendit.
262.	Parashikimin në ligj të publikimit të pasurive të gjyqtarëve/prokurorëve në një web site zyrtar, duke marrë parasysh privatësinë dhe sigurinë e gjyqtarëve/prokurorëve dhe familjarëve të tyre, të cilët janë gjithashtu subjekt i ligjit të deklarimit.
263.	Parashikimin në ligj si një ndër shkaqet e nisjes së procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve edhe mosdeklarimin, deklarimin tej afateve ose deklarimin jo të plotë të pasurisë dhe konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës, duhet të shoqërohet me një mekanizëm ballancues, psh. vlerësimi nga një aktor i tretë Kryetari i Gjykatës së Lartë/ Prokurori i Përgjithshëm/ KLD i denoncimit të ILDKPKI.
264.	Shkrimi e 2 inspektoriateve në 1, duke shkrirë Inspektoratin ekzistues pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe duke mbetur vetëm ai pranë KLD, e shoqëruar kjo me të paktën dy-trefishim të numrit të inspektorëve të KLD, si dhe rritje të pagave të tyre dhe fuqizim të statusit.
265.	Dixhitalizimi i sistemit monitorimi në gjykata, me qëllim identifikimin e shpeshtë dhe të menjëhershëm të gjyqtarëve devijantë dhe procedimi me shpejtësi të tyre nga organet kompetente.
266.	Lidhur me një Tribunal të vecantë Disiplinor (si një organ <i>ad hoc</i> ky me përbërje mikse gjyqtarë dhe jogjyqtarë), vlerësojmë se krijimi i institucioneve të reja duhet të mbajë parasysh riskun e lartë të përfitimit politik të mazhorancës aktuale nisur nga shumica që disponon në Kuvend. Ngritja e institucioneve të reja mbart riskun e fragmentarizimit të tepruar institucional dhe eventualisht edhe mungesën e bashkëpunimit të shëndoshë në arritjen e rezultateve të kërkuara. Vetëm një model evropian i cili duhet të garantojë 100 % shmangien e ndikimit politik të kontrollit të gjyqtarëve e prokurorëve mund të ishte një çështje që do mund të diskutohet gjerësisht në tryezat konsultative. Në mbeshtesim kontrollin gjyqësor ndaj çdo vendimi duke eliminuar ndikimin politik i cili vjen nga emerimi i antareve jo gjyqtare.
267.	Parashikimi në ligj i kufizimeve përkatëse për gjyqtarët dhe prokurorët pas shërbimit, në lidhje me punësimin si avokatë privatë ose këshilltarë ligjorë për subjektet tregtare, të cilat mund të përfitojnë nga ndikimi i tyre në sistemin e drejtësisë.
268.	Të parashikohen ndërhyrjet e përshtatshme ligjore për rikonceptimin e rolit dhe kompetencave të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, duke synuar fuqizimin e këtij institucioni të fuqishëm antikorrupsion dhe

	shmangjen e kapjes politike të tij.
269.	Rritja e pagës së gjyqtarëve/prokurorëve me 30 % cdo vit, për një periudhë 5 vjet.
270.	Dedikimi i burimeve financiare të posacme dhe të mjaftueshme me qëllim rindërtimin apo modernizimin, aty ku është e nevojshme, të ambjentëve të gjykatave dhe prokurorive, sigurimi i kushteve të përshtatshme dhe dinjitoze për gjyqtarët dhe prokurorët, si masë e fuqishme për parandalimin e korrupsionit.
271.	Heqjen e kompetencës ekskluzive të Ministrit të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve. Kjo e drejtë t’i njihet edhe vetë Inspektoratit të KLD, Prokurorit të Përgjithshëm, Kryetarëve të Gjykatave. Vlerësojmë se implementimi i kësaj mase do të rriste numrin e gjyqtarëve të proceduar, por njëkohësisht do t’i mbronte ata nga mbajtja nën presion nga ekzekutivi.
272.	Përmirësimi i rregullave të sistemit të promovimit, transferimit dhe procedimit disiplinor të gjyqtarëve/prokurorëve, sipas propozimeve të bërë në nëncështjen “Pushteti Gjyqësor” dhe “Drejtësia Penale”.

VII. FINANCIMI I SISTEMIT TË DREJTËSISË

273.	<p>Për pjesën e financimit të sistemit të drejtësisë duhet të shpallen 3 objektiva madhor:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsolidimi dhe garantimi i pavarësisë financiare të sistemit të drejtësisë, për të siguruar administrimin e pavarur të buxhetit gjyqësor/prokurorisë, përmirësimin e bashkëpunimin ndërinstitucional dhe garantimin e një skeme funksionale financimi. - Mbështetjen e nevojshme financiare të sistemit gjyqësor, për të siguruar eficientë dhe efikasitetin e organeve të tij dhe përmbushjen e misionit për dhënien e drejtësisë pa asnjë pengesë apo vonesë. - Mbështetjen e nevojshme financiare të organeve të tjera të sistemit të drejtësisë, për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të rritur eficientë dhe efikasitetin në punën e tyre.
274.	Zgjidhja e parë e preferueshme nga ana jonë është që kompetenca e administrimit të buxhetit gjyqësor t’i kalojë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
275.	Nëse opsioni i kalimit të kompetencës për administrim e buxhetit KLD-së do të vlerësohet se mbingarkon këtë të fundit, vlerësojmë se është e domosdoshme hartimi i një ligji të ri për hartimin dhe administrimin e buxhetit gjyqësor, i cili të sigurojë edhe rishikimin e strukturës së organeve ekzistuese.
276.	Bordi Drejtues i ZABGJ është organi më i lartë vendimmarrës i këtij institucioni. Si i tillë, duhet të jetë përgjegjës për planifikimin e duhur të buxhetit gjyqësor, mbrojtjen e projektbuxhetit të hartuar, zbatimin dhe administrimin e buxhetit gjyqësor, kontrollit mbi mënyrën e zbatimit dhe administrimit të buxhetit të miratuar, garantimit të funksionimit normal të gjykatave nga pikëpamja financiare, hartimit të planeve afatgjata buxhetore, miratimit të investimeve/projekteve prioritare, harmonizimit të politikave të veta me politikat qeveritare për sistemin gjyqësor, përcaktimit të rregullave dhe procedurave për zbatimin e buxhetit nga strukturat financiare të gjykatave dhe niveleve të lejuara të shpenzimeve, si dhe çdo vendimmarrje tjetër në funksion të shpërndarjes së burimeve sipas objektivave të paracaktuara dhe përdorimit ekonomik, eficient dhe efektiv të buxhetit të gjykatave.

277.	<p>Përbërja e Bordit Drejtues të ZANGj-së të jetë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kryetari i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë; - Një kryetar i gjykatës së apelit, i cili zgjidhet nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare; - Dy kryetarë të gjykatave të shkallës së parë, të cilët zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare; - Një kancelar dhe një përfaqësues i sektorit të financave nëpër gjykata, të zgjedhur me short nga anëtarët e tjerë të Bordit Drejtues. - Një anëtar i KLD, i zgjedhur me shumicën e votave të anëtarëve të këtij organi; - Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë; - Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave.
278.	<p>Ligji duhet të parashikojë rregullat mbi qëndrimin në detyrë të anëtarëve të Bordit (mandatin e anëtarëve, i cili nuk duhet të jetë shumë i shkurtër, por të jetë i barabartë me afatin e planeve afatmesme) dhe përfundimin e detyrës së anëtarit të Bordit (përjashtuar Kryetarit të Gjykatës së Lartë), thirrjen e mbledhjes, përcaktimin dhe njoftimin e rendit të ditës, kuorumin e nevojshëm dhe formën e votimit, mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes, thirrjen e personave të tretë në mbledhjen e Bordit, mekanizmin e nevojshëm që garanton zbatimin e vendimeve të Bordit, si dhe pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të Bordit për çdo problem apo çështje që lidhet me administrimin e buxhetit gjyqësor.</p>
279.	<p>Rregullat e funksionimit të ZABGJ duhet të sigurojnë respektimin e parimit të mirëfunksionimit, transparencës, ligjshmërisë, pavarësisë së pushtetit gjyqësor; mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit. Veprimtaria e Bordit Drejtues duhet të udhëhiqet nga këto kritere administrimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi ekonomik, eficient dhe efektiv i burimeve financiare; - Parashikueshmëria; - Gjithëpërfshirja; - Uniteti dhe universaliteti në menaxhimin e fondeve buxhetore.
280.	<p>Ligji duhet të parashikojë mekanizmin e nevojshëm për bashkëpunimin e Bordit Drejtues dhe Drejtorit të ZABGJ, në funksion të përmbushjes së misionit të përbashkët për menaxhimin e buxhetit gjyqësor. Ndërkohë duhet të parashikohet mekanizmi që siguron informimin e vijueshëm të Bordit Drejtues mbi çështjet problematike si dhe me veprimtarinë e përditshme të ZABGJ.</p>
281.	<p>Në funksion të rritjes së performancës së Drejtorit të ZABGJ është e nevojshme që ligji të parashikojë ngritjen e komisioneve të përbërë nga anëtarë të Bordit Drejtues, të cilët çdo muaj duhet të ndjekin/mbikëqyrin nga afër veprimtarinë e Drejtorit dhe administratës së ZABGJ.</p>
282.	<p>Në funksion të përzgjedhjes së personit më të përshtatshëm në pozicionin e Drejtorit të ZABGJ është e nevojshme që ligji të parashikojë kriteret për emërimin e tij. Gjithashtu, duhet të detajohen procedurat e përzgjedhjes, të cilat duhet të sigurojnë parimin e transparencës dhe konkurrueshmërisë. Përcaktimi i mandatit për Drejtorin e ZABGJ, vlerësojmë se rrit përgjegjshmërinë e tij për realizimin e detyrës. Në çdo rast duhet të mbahet në konsideratë që mandati i Drejtorit nuk duhet të jetë i shkurtër, por minimalisht të jetë 5 vjet, për të siguruar vazhdimësi në përmbushjen e detyrave dhe prioriteteve disavjeçare. Përcaktimi i mandatit të Drejtorit të ZABGJ duhet të shoqërohet me specifikimin në ligj të rasteve për lirim dhe shkarkimin e tij nga detyra.</p>
283.	<p>Ligji të parashikojë që administrata e ZABGJ gëzon statusin e nëpunësit civil.</p>

	Përfshirja e administratës së ZABGJ në rrethin e nëpunësve civil është një garanci për rritjen e kapaciteteve të saj.
284.	Rregullat dhe procedurat që duhet të ndiqen në përgatitjen, shqyrtimin, miratimin, zbatimin dhe administrimin e buxhetit të gjykatave duhet të jenë specifike dhe të veçanta. Administrimi i buxhetit të gjykatave dhe procedurat e bashkërendimit me ministrinë përgjegjëse për financat nuk duhet dhe nuk mund të jenë të njëjta si për ZABGJ, ashtu edhe për ministritë e linjës.
285.	Të rritet kontrolli i ZABGJ mbi mënyrën e përdorimit të fondeve buxhetore nga gjykatat, në përputhje me ligjin nr. 10296/2010, duke mbajtur parasysh specifikat që paraqet ky organ. Gjithashtu, auditimi i veprimtarisë së ZABGJ-së duket se nuk është në harmoni me legjislacionin në fuqi për auditimin e fondeve në sektorin publik dhe konkretisht ligjin nr. 9720/2007 dhe për pasojë është e nevojshme që ligji të parashikojë rregulla të veçanta auditimi në harmoni me legjislacionin në fuqi.
286.	Është e nevojshme që ligji të parashikojë mekanizmat e duhura të bashkëpunimit/ndërveprimit midis ZABGJ, organeve të sistemit të drejtësisë dhe institucioneve të tjera shtetërore.
287.	KLD të financohet në mënyrë të tillë që të mundësohet funksionimi sic duhet i këtij organi. Ajo duhet të ketë mjetet e duhura për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe autonome, si dhe fuqinë dhe kapacitetin për të negociuar dhe për të organizuar buxhetin e vet në mënyrë efektive.
288.	Me ligj të përcaktohet se raporti i buxhetit të gjykatave me PBB të vendit të mos jetë më i ulët se 0.20%. Në sigurimin e këtij financimi mund të vlerësohet edhe mundësia që sistemi gjyqësor të ketë mundësi të përdorë vetë fondet që sigurohen nga tarifat gjyqësore.
289.	Është e nevojshme që të përcaktohet një Plan Masash që parashikon se cilat gjykata apo prokurori do të ndërtohen apo rikonstruktohen në 5 vitet e ardhshme. Në evidentimin e tyre duhet të luaj rol thelbësor mendimi i vetë aktorëve të sistemit.
290.	Dixhitalizimi i mëtejshëm i veprimtarisë së sistemit gjyqësor, vlerësojmë se ndihmon jo vetëm në rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, por edhe në uljen e kostove financiare. Në këtë drejtim, vlerësojmë të nevojshme identifikimin e saktë të veprimtarive që duhet të dixhitalizohen. Gjithashtu, në funksion të monitorimit të sistemit, do të ishte e përshtatshme që të përfshihet edhe mundësia për regjistrimin video të seancave gjyqësore, si një formë që rrit përgjegjshmërinë e gjyqtarëve dhe mundësinë për mbikëqyrjen e tyre nga organet përgjegjëse.
291.	Është e nevojshme që të përcaktohet një Plan Masash që parashikon se cilat IEVP do të ndërtohen apo rikonstruktohen në 5 vitet e ardhshme.
292.	Fuqizimin e kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës dhe forcimin e mësbtetjes financiare ndaj saj.
293.	Parashikimi në ligj i një mekanizmi të përshtatshëm që sistemi gjyqësor të përdori të ardhurat e mbledhura nga tarifat gjyqësore, në një masë më të madhe.
294.	Përsa i përket pagës së gjyqtarëve/prokurorëve ritheksojmë se ajo duhet të pësojë një rritje graduale, të shtrirë në 5 vite, në masën 30 % cdo vit.